



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 361 Akti

Nr. 381 Vendimi  
Tiranë, më 6.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Xhensila Pine</b>	<b>Anëtare</b>

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datat 15.4.2021, ora 10:00 dhe 30.4.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ramazan Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.**

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “E” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**  
**Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.**

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**V Ë R E N :**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Ramazan Avdiu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionerin Olsi Komici. Vëzhguese ndërkombëtare e çështjes është caktuar znj. Marie Tuma.

3. Në datën 8.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.

4. Subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
6. Në datën 11.3.2021, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe në vijim vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, në bazë të nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
7. Komisioni njoftoi, nëpërmjet postës elektronike, subjektin e rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe gjetjet e Komisionit, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.
8. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë për shtesë të afatit lidhur me dorëzimin e parashtimeve mbi rezultatet e hetimit, e cila u pranuar nga Komisioni dhe u njoftua për shtyrjen e afatit nga data 22.3.2021 në datën 5.4.2021.
9. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit. Së bashku me shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë dhe thirrjen e disa dëshmitarëve, si dhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale.
10. Komisioni ka pranuar dhe administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura prej tij. Komisioni, me vendimin e datës 13.4.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se nuk ka pranuar kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ, pasi deri në këtë fazë të hetimit konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ka refuzuar kërkesën e subjektit për thirrjen si dëshmitarë të disa shtetasve, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit për arsyet e refuzimit.
11. Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, në seancë dëgjimore në datën 15.4.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.
12. Në datën 15.4.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve u zhvillua seanca dëgjimore, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore. Pasi mori fjalën, subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë për trupin gjykues ku kërkonte riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, për arsye të një gabimi material në analizën financiare dhe riçeljen e hetimit administrativ edhe për të dyja kriteret e tjera.
13. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi për të vlerësuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe, më tej, e njoftoi se ka pranuar pjesërisht kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë me qëllim saktësimin e një gabimi material në pasqyrimin e gjendjes *cash* në analizën financiare në një vit dhe ridërgimin e analizës së rishikuar subjektit të rivlerësimit, duke shtyrë seancën dëgjimore deri në një njoftim të dytë.
14. Komisioni i dërgoi subjektit të rivlerësimit në datën 16.4.2021 tabelën e korrigjuar të analizës financiare dhe e njoftoi për vijimin e seancës dëgjimore në datën 26.4.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.
15. Z. Ramazan Avdiu ka kërkuar në datën 19.4.2021 të njihet me procesverbalin e zbardhur të seancës dëgjimore dhe vendimin e zbardhur me të cilin u njoh gjatë seancës dëgjimore për pranimin e pjesërisht të kërkesës së tij.
16. Në datat 20.4.2021 dhe 21.4.2021 Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, informacionin e kërkuar.

17. Z. Ramazan Avdiu i është drejtuar në datën 21.4.2021 Komisionit me një kërkesë për shtyrje të seancën dëgjimore, duke paraqitur edhe shkaqet konkrete të kërkesës së tij.

18. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën, e pranoi atë duke shtyrë seancën dëgjimore në datën 30.4.2021, ora 10:00, si dhe duke njoftuar subjektin e rivlerësimit. Komisioni i bëri me dije subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces me kohëzgjatje të kufizuar dhe, për pasojë, nuk mund të shtyhet në vijimësi ky proces dhe në rast pamundësie për të qenë prezent në seancën dëgjimore, Komisioni i sjell në vëmendje subjektit të rivlerësimit se mund të përfaqësohet nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor, sipas parashikimeve të neneve 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative.

19. Në datën 29.4.2021 subjekti i rivlerësimit dërgoi, nëpërmjet adresës elektronike, shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit dhe informacionin shtesë të dërguar në datën 16.4.2021.

20. Në datën 30.4.2021, ora 10:00, vijoi seanca dëgjimore në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore, gjatë të cilës dha shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

21. Në përfundim të seancës dëgjimore, z. Ramazan Avdiu kërkoi riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, duke vlerësuar të gjitha faktet dhe provat, si dhe riçeljen e hetimit administrativ për të dyja kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të aftësive profesionale dhe të figurës.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

### A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)<sup>1</sup> ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me të, ka konstatuar se: (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

24. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>2</sup>, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi.

25. Në Deklaratën e Pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

**1. Bashkëpronar në pasuritë e paluajtshme, në fshatin T., Gramsh:** (a) tokë arë me sip. 13.670 m<sup>2</sup> (sipas AMPT-së 11.713 m<sup>2</sup>), z. k. \*\*\*, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; (b) tokë arë me sip. 4.734 m<sup>2</sup> (sipas AMPT-së 4.630 m<sup>2</sup>), z. k. \*\*\*, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; (c) tokë arë me sip. 3.000 m<sup>2</sup> (sipas AMPT-së 1.700 m<sup>2</sup>), z. k. \*\*\*, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; (ç) ngastrat Fusha mbi rrugë, me sip. 270 m<sup>2</sup>, Fusha mbi rrugë me sip. 199 m<sup>2</sup>, Driza e Bakut me sip. 100 m<sup>2</sup>, sipas AMPT-së të paregjistruara në ZVRPP. Pasuri e fituar nga pronësia e fituar si

<sup>1</sup> Procedura e vlerësimit të pasurisë: 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

<sup>2</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i papabuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultun se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

familje në vitin 1992 me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, nga ndarja e tokës së ish-kooperativës, pa shpërblim.

1.1 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në janar të vitit 1995 është pjesëtuar ngastra Bregu i Sadushit dhe është veçuar sip. 3.724 m<sup>2</sup>, marrë nga vëllai P. A.. Pjesëtimi nuk është pasqyruar në ZVRPP-në Gramsh. Pronat janë në pronësi të familjes me kryetar S. A., banues në T.. Pjesa e fituar si bashkëpronar mbi këto pasuri është 1/17 dhe pjesa e anëtarëve të tjerë 2/17. Me trashëgim nga nëna, subjekti ka fituar 1/8 e pjesës së saj. Nuk është regjistruar vendimi i lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë. Pjesa e subjektit në këto pasuri shkon  $1/17 + 1/8 + 2/17 = 9/8 \times 17$ . Regjistrimi është bërë nga vetë ZVRPP-ja Gramsh dhe subjekti nuk ka kryer asnjë veprim për marrjen e certifikatës, prandaj ka mospërputhje mes regjistrimit, AMTP-së dhe gjendjes faktike. Pjesa në sipërfaqe sipas AMTP-së është 1.095 m<sup>2</sup>. Këto pasuri përdoren nga familja e babait të tij, nga e cila subjekti është veçuar në dhjetor të vitit 1996. Në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës”, tokat arë të fshatit T., Bashkia Gramsh, vlerësohen në masën 174 lekë/m<sup>2</sup>. Në bazë të kësaj vlere për njësi, sipërfaqja ideale që zotëron subjekti kap vlerën 190.530 lekë. Pjesa takuese: 6.6 %. Pjesa në sipërfaqe sipas AMTP-së është 1.095 m<sup>2</sup>. Bashkëpronarë të tjerë: S., P., K., B., A. e A. A. dhe V. Sh..

1.2 Zyra Vendore Gramsh e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës konfirmon për Komisionin<sup>3</sup> këtë pasuri, të llojit “arë”, me sip. 21.404 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në fshatin T., Bashkia Gramsh, përfitur në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore nga shtetasi S. A. A., ku në cilësinë e bashkëpronarit, referuar gjendjes familjare të datës 1.8.1991, është edhe subjekti i rivlerësimit.

1.3 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në Deklaratën e Pasurisë *Vetting*, datë 25.1.2017, duke deklaruar si pjesë sip. 1.095 m<sup>2</sup> sipas AMTP-ve, e cila kap vlerën 190.530 lekë, referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës”. Bazuar në paragrafin 1, germa “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit duhet ta kishte deklaruar këtë pasuri në Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasuri të vitit 2003.

1.4 Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Është e vërtetë që nuk e kam deklaruar pjesën e bashkëpronësisë mbi parcela toke arë, të fituara nga ligji për tokën, ku pjesa ime ishte 1/17. Kjo pasuri është fituar falas nga shteti dhe pjesa ime është mjaft e vogël: në sipërfaqe 1.095 m<sup>2</sup>. Por ka kaluar kohë e gjatë nga deklarimi i parë (i bërë në vitin 2004 për vitin 2003) dhe nuk mbaj mend saktësisht pse nuk e kam bërë këtë deklarim.*

*E kam deklaruar në Deklaratën *Vetting* se më detyronte ligji të deklaroja me saktësi çdo pasuri dhe nëse nuk e deklaroja prezumohej masa disiplinore. Por për mua ajo as nuk ka pasur edhe as nuk ka ndonjë vlerë. Mosdeklarimi në DVP-në e vitit 2003 nuk ka pasur qëllim për fshehje pasurie dhe për këtë shkak vlerësoj se mosdeklarimi i kësaj pasurie në vitin 2003 nuk duhet të konsiderohet deklarim i pamjaftueshëm”.*

1.5 Subjekti ka deklaruar pasurinë në Deklaratën *Vetting*, duke përmbushur detyrimin që rrjedh sipas ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi ndër vite, sipas detyrimeve që vinë nga ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nuk rezulton i qëllimshëm, si dhe nuk ngre dyshime për Komisionin.

**2. Bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme truall, me sip. 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. të regj. 70 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*\* (gabim regjistrimi pasi në fakt është rreth 104 m<sup>2</sup>), z. k. \*\*\*.** Subjekti deklaron se pasuria është banesa e prindërve S. dhe H. A., ndërtuar në vitin 1985 me të ardhura nga puna e tyre nga lidhja e martesës rreth vitit 1964 deri në 1984 dhe nuk e zotëron, si dhe nuk përfiton të ardhura prej saj. Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim: *fituar me trashëgim nga nëna (1/8 e pjesës së saj ideale prej 1/2), ku pjesa ideale e subjektit është 1/16.*

2.1 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në Deklaratën e Pasurisë *Vetting* në datën 25.1.2017, duke deklaruar si pjesë ideale 1/16 e saj.

2.2 Zyra Vendore Gramsh e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës konfirmon për Komisionin<sup>4</sup> këtë pasuri, të llojit “truall”, me sip. 300 m<sup>2</sup>, nga e cila sip. 70 m<sup>2</sup> është ndërtesë, z. k. \*\*\*, në fshatin T., Bashkia Gramsh,

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, të Zyrës Vendore Gramsh të ASHK-së.

<sup>4</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, të Zyrës Vendore Gramsh të ASHK-së.

përfiturar në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore nga shtetasi S. A. A., ku në cilësinë e bashkëpronarit, referuar gjendjes familjare të datës 1.8.1991, është edhe subjekti i rivlerësimit.

2.3 Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit deklaroi<sup>5</sup> se një pjesë e të ardhurave të dërguara nga vëllezërit emigrantë në Angli (K. dhe B. A.), në vlerën rreth 1.200.000 lekë, u përdorën nga prindërit për riparimin e banesës së tyre në fshatin T., Gramsh, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2002.

2.4 Lidhur me këtë pasuri rezultoi se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën e interesave private përkatëse pjesën e zotëruar prej tij, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".
- b) Nuk është e qartë sipërfaqja reale e ndërtesës, ndërhyrjet, shtesat dhe modifikime të tjera të kryera në këtë pasuri ndër vite, kur janë realizuar, si dhe burimi i të ardhurave.
- c) Mosdeklarimi i kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur kontrollin dhe verifikimin e saj nga ILDKPKI-ja.

2.5 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar të kundërtën e rezultatit të hetimit lidhur me këtë pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

2.6 Subjekti i rivlerësimit sqaron si vijon:

*"Mbi pasurinë truall dhe banesë, me sipërfaqe truall 300 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, unë nuk kam pasur të drejta pronësie në vitin 2003. Kjo për faktin se banesa është ndërtuar nga prindërit rreth vitit 1985 dhe në bazë të nenit 86 të Kodit Civil, të vitit 1981, pronësinë mbi të e fituan në kohën e ndërtimit prindërit. Me ligjin nr. 7512/1991 (neni 21), si pronarë të ndërtesës, prindërit e mi fituan edhe pronësinë mbi truallin. Pra, në vitin 2003 bashkëpronarë të banesës kanë qenë vetëm prindërit e mi ...*

*Pavarësisht se në AMTP shënohet se familjes së S. A. i është dhënë edhe 300 m<sup>2</sup> truall, ky disponim i Komisionit nuk është i vlefshëm, pasi ata e kishin fituar pronësinë në bazë të ligjit nr. 7512/1991 dhe komisionet e tokave në fshat, në bazë të VKM-së nr. 255/1991, ndanin vetëm tokat e kadastruara si toka bujqësore dhe jo trojet me banesa mbi to. Pra, këtë pjesë nuk kisha detyrim ta deklaroja në vitin 2003, pasi nuk kisha të drejta. Unë kam fituar ligjërisht pronësinë mbi 1/16 pjesë të banesës në janar të vitit 2009, kur ndërroi jetë nëna ime, por nuk e kam marrë asnjëherë posedimin e saj. Nuk kemi kryer ndonjë veprim në ZVASHK-në Gramsh për të regjistruar dëshminë e trashëgimisë së nënës.*

*Në vitin 2002, kur është bërë riparimi i saj me të ardhurat e siguruara nga puna e dy vëllezërve në Angli, nuk kam qenë anëtar i familjes së prindërve. Unë nuk kam detyrim të provoj burimet e pasurisë së prindërve, pasi pasuria nuk ishte e imja dhe ishte krijuar nga prindërit në një kohe kur unë, fëmija i tyre i madh, sapo kisha kaluar miturinë. Vëllezërit që shkuan në Angli kanë punuar në informalitet dhe nuk mund të paraqes ndonjë dokument për sigurimin e të ardhurave në rrugë formale".*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

2.7 Sipas shkresës së Zyrës Vendore Gramsh të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi e regjistruar pasuria e llojit "truall", me sip. 300 m<sup>2</sup>, nga e cila 70 m<sup>2</sup> ndërtesë, z. k. \*\*\*, në fshatin T., Bashkia Gramsh, përfiturar në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore nga shtetasi S. A. A., ku në cilësinë e bashkëpronarit, referuar gjendjes familjare të datës 1.8.1991, është edhe subjekti i rivlerësimit. Nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të jetë kundërshtuar akti i marrjes në pronësi të kësaj pasurie dhe regjistrimi në emër të tij.

2.7.1 Pas vdekjes së nënës në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka trashëguar 1/16 pjesë ideale në këtë pasuri, por përsëri nuk e ka deklaruar në DIPV-në përkatëse.

<sup>5</sup> Shihni përgjigjen nr. 7 të pyetësorit të datës 8.1.2020.

2.7.2 Lidhur me barrën e provës, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion vetëm për të ardhurat e prindërve (aktet e dosjes së tyre të pensionit) për të provuar se deri në vitin 1985 kanë qenë në marrëdhënie pune, e kanë siguruar të ardhura për mbajtjen e familjes dhe kanë kursyer për ndërtimin e banesës.

2.7.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar informacion lidhur me burimin e të ardhurave të vëllezërve emigrantë në Angli (K. dhe B. A.), pasi deklaroi se ata kanë punuar në informalitet dhe nuk mund të paraqesë ndonjë dokument për sigurimin e të ardhurave në rrugë formale.

2.8 Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar pasurinë në Deklaratën *Vetting*, duke përmbushur detyrimin që rrjedh sipas ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi ndër vite, sipas detyrimeve që vinë nga ligji nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nuk ka mundur kontrollin nga ILDKPKI të veprimeve/investimeve të kryera në atë pasuri, e verifikimi i asaj situete pas një kohe kaq të gjatë rezultoi i vështirë për Komisionin. Në vlerësim të fakteve dhe provave sa më sipër, trupi gjykues ka vlerësuar të mos e përfshijë këtë pasuri dhe problematikat që ajo mbart, në rivlerësimin e subjektit Ramazan Avdiu, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se ai ka jetuar në familjen e prindërve deri në vitin 1995 dhe, më tej, ka jetuar i ndarë prej tyre në qytetin e Gramshit.

**3. Pasuria “tokë arë”, me sip. 2.000 m<sup>2</sup>, në fshatim T., Gramsh,** e blerë me Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2009, në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë, nga bashkëpronarët Shaban Tocila, etj., që e kishin fituar këtë tokë nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”. Në bashkëpronësi me bashkëshorten nga 50 %. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të ardhura nga paga dhe kursimet e viteve të mëparshme.

3.1 Zyra Vendore Gramsh e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës konfirmon për ILDKPKI-në pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit “arë”, e ndodhur në fshatin T., Gramsh, në emër të subjektit të rivlerësimit, përfituar me Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2009. Sipas kontratës së shitjes, çmimi i blerjes është në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

3.2 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijim e kësaj pasurie me të ardhura të vitit 2009, pavarësisht problematikave të tjera të konstatuara për këtë vit në analizën financiare. Për më shumë detaje referojuni analizës financiare të detajuar.

**4. Apartament banimi, me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, në Gramsh,** blerë me kontratën e datës 9.11.1996, në vlerën 420.000 (katërqind e njëzet mijë) lekë, nga bashkëshortët Y. dhe A. B., rivlerësuar në datën 13.8.2012, me vlerën 2.069.760 (dy milionë e gjashtëdhjetë e nëntë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të ardhurat vetjake të siguruara më parë nga paga dhe të ardhurat nga shitja e një mjeti bujqësor (minitraktor-zetor), të cilin e kishte marrë më herët me kredi.

4.1 Kjo pasuri është deklaruar në Deklarimin Fillestar në vitin 2003, si: “*Shtëpi banimi 1+1, me vendndodhje në: Gramsh, blerë nga të ardhurat e siguruara nga paga dhe me huamarrje të shlyer më pas. Banesa është blerë në tetor të vitit 1996 dhe huat e marra për këtë blerje janë shlyer deri në vitin 1998*”.

4.2 Në Deklaratën e Pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Blerë me të ardhurat e mia të siguruara më parë nga paga dhe pjesërisht një hua që kisha marrë në atë kohë. Në janar 1994 kam marrë një kredi në ish-Bankën Bujqësore Shqiptare për blerjen e një mjeti bujqësor (minitraktor-zetor) për nevojat e familjes sime në fshat, mjet që ia kam shitur në vitin 1996 shtetasit B. S., banues në fshatin T.. Nga çmimi mbajta pjesën e pashlyer të kredisë, që e përdora për blerjen e banesës. Kreditin më pas, me të ardhurat nga paga, e kam shlyer vetë dhe e kam përfunduar në fund të vitit 1997 ose fillim 1998. Kredia ka qenë rreth 400.000 lekë (4.000 USD) dhe kam përdorur rreth 1/4 e saj për blerjen e apartamentit (rreth 100.000 lekë)*”.

4.3 ZVRPP-ja Gramsh<sup>6</sup> ka konfirmuar këtë pasuri, duke dërguar edhe praktikën e plotë të origjinës së saj. Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë apartament me Kontratën e Shitjes, datë 9.11.1996, nga shtetasit Y. dhe A. B., të cilët e kishin blerë këtë apartament nga Ndërmarrja Komonale Banesa Gramsh në procesin e privatizimit të banesave shtetërore.

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr\*\*\* prot., datë 1.8.2017, të ZVRPP-së Gramsh, në dosjen e ILDKPKI-së.

4.4 Komisioni ka kërkuar<sup>7</sup> nga subjekti i rivlerësimit të paraqesë dokumentacion ligjor në lidhje me blerjen dhe shitjen e minitraktorit, të ardhurat e të cilit kanë shërbyer pjesërisht si burim për blerjen e këtij apartamenti në shumën 420.000 (katërqind e njëzet mijë) lekë.

4.5 Subjekti i rivlerësimit sqaron<sup>8</sup> se apartamentin e ka blerë me të ardhurat e siguruara nga paga, kursime të viteve të mëparshme dhe një hua/kredi të marrë në dhjetor 1993 – janar 1994, në ish-Bankën Bujqësore, dega Gramsh për blerjen e një mjeti bujqësor për nevojat e familjes në fshat. Sipas subjektit të rivlerësimit, mjetin bujqësor e ka shitur në vitin 1996 te shtetasi B. S. dhe nga çmimi ka mbajtur pjesën e pashlyer të kredisë, ndërsa pjesën tjetër ua ka ka kthyer vëllezërve. Pjesën që mbajti deklaroi se e përdori për blerjen e apartamentit dhe kredinë e ka shlyer me të ardhurat nga paga në fund të vitit 1997 ose në vitin 1998. Kredia ka qenë rreth 400.000 (katërqind mijë) lekë [4.000 (katër mijë) USD] dhe rreth 1/4 e ka përdorur për blerjen e apartamentit [rreth 100.000 (njëqind mijë lekë)]. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka asnjë dokument për marrjen e kredisë apo për shitjen e minitraktorit. Lidhur me shitjen e minitraktorit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2020, të blerësit të minitraktorit (B. S.), i cili deklaroi blerjen e minitraktorit nga subjekti në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

4.6 Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në përgjigje të pyetjeve të Komisionit<sup>9</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në datën 13.1.2020 informacion në rrugë shkresore tek Agjencia e Trajtimit të Kredive (ATK), Banka Kombëtare Tregtare (BKT) dhe “Raiffeisen Bank”, lidhur me këtë kredi.

a) BKT-ja, në përgjigjen e datës 29.1.2020, sqaron se informacioni i kërkuar është dorëzuar pranë Arkivit Qendror të Shtetit ose është asgjësuar për shkak të kalimit të afateve për ruajtje.

b) ATK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020, informon se dosja e subjektit të rivlerësimit nuk ndodhet pranë këtij institucioni.

c) “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2020, sqaron se nuk i disponon dosjet e kredive të ish-Bankës Bujqësore, dega Gramsh dhe e orienton t’i drejtohet ATK-së.

4.7 Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka depozituar<sup>10</sup> edhe shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2020, sipas të cilës, në bazë të regjistrit të hyrjes së fondeve të ASHV-së Elbasan, rezulton se ish-Banka Bujqësore e Shtetit Shqiptar, dega Gramsh, nuk ka dorëzuar dokumente kredie te ky institucion.

4.8 Nga analiza financiare e kryer, duke marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1989 – 1996, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të krijonte kursime kumulative në lekë deri në nëntor të vitit 1996, në shumën 184.310 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e dhjetë) lekë.

4.9 Nga hetimi për këtë pasuri ka rezultuar se:

a) Ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues që të provojë marrjen dhe shlyerjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e minitraktorit, si dhe për shitjen e këtij mjeti. Nuk provohet e ardhura në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë e përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 1996.

b) Duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me burime nga të ardhurat nga paga për të krijuar pasurinë në vitin 1996, në vlerën 320.000 (treqind e njëzet mijë) lekë, po ashtu edhe vlera prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh mbetet e paprovuar.

4.10 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

4.11 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se është në pamundësi për sigurimin e dokumentacioni provues për kredinë e marrë, shlyerjen e saj dhe shitjen e minitraktorit dhe në bazë të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se dokumentacioni nuk mund të disponohet, kërkon nga Komisioni që mosparaqitja e dokumentacionit të konsiderohet për shkaqe të justifikuar dhe të pranohet prova me dëshmitarë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se kredinë e kanë marrë në vitin 1994 vëllezërit e tij emigrantë në Greqi, të cilën e shlyenin nga puna e tyre. Ky mjet është marrë për punime në fshat nga anëtarët

<sup>7</sup> Shihni pyetjen nr. 1, në pyetësorin e datës 2.3.2020.

<sup>8</sup> Shihni përgjigjen nr. 1, në pyetësorin e datës 2.3.2020.

<sup>9</sup> Shihni përgjigjen nr. 9, në pyetësorin e datës 8.1.2020.

<sup>10</sup> Shihni plotësimin e përgjigjes 1, me nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020.

e familjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga shitja e këtij mjete në vitin 1996, pasi nuk e përdornin më, ka marrë shumën e mbetur për t'u shlyer kredia dhe pjesën tjetër ia ka dhënë vëllezërve. Kredia ka vazhduar të shlyhet nga të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit deri në vitin 1997 - 1998.

4.12 Lidhur me të ardhurat e përfituara prej tij, subjekti i rivlerësimit shpjegon si vijon:

*“Gjatë periudhës 1989 – dhjetor 1993 – nga të dhënat e marra nga Zyra Arsimore Gramsh, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016, rezulton se në periudhën shkurt – dhjetor 1993 më janë paguar të ardhura (neto) në shumën 36.374 lekë nga paga dhe shumën 11.620 lekë të ardhura nga lëvizjet në shërbim (është e rëndësishme që edhe këto të përfshihen, pasi kanë qenë të ardhura sa 32% e pagës dhe kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve jetësore), në total në shumën 47.694 lekë. Shtuar në ulje edhe paga e janarit të vitit 1993 në shumën prej 1.000 lekësh (për të cilën nuk kam gjetur referencë të saktë, por paga neto e muajit shkurt të vitit 1993 ka qenë 3.000 lekë), totali i të ardhurave që më janë paguar në vitin 1993 arrin në vlerën 48.694 lekë.*

*Gjatë periudhës janar 1994 – prill 1995 – në Deklaratën Vetting, për mungesë të të dhënave të sakta, kam deklaruar një page neto në masën jo më të ulët se 100.000 lekë. Në këtë deklaram i jam referuar të dhënave të muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 1994 (sipas vërtetimit përkatës), ku siguroja nga paga rreth 4.500 lekë/muaj dhe të dhënave të katërmujorit të parë të vitit 1995 ku kisha një pagë bruto prej 14.250 lekësh. Në Deklaratën Vetting kam llogaritur për vitin 1994 në shumën rreth 60.000 lekë të ardhura dhe për janar - prill 1995 në shumën rreth 40.000 lekë. Në fakt, gjatë periudhës 16 janar – 31 dhjetor 1994 kam pasur pagë bruto jo më të ulët se 12.000 lekë/muaj. Kjo provohet nga ligji nr. 7800, datë 2.3.1994, në të cilin paga bruto e hetueseve në rrethet e kategorisë II është në vlerën 12.000 lekë/muaj dhe efektet financiare të këtij ligji kanë filluar nga data 16.1.1994. Këtë fakt nuk e mbaja mend dhe kam bërë deklaramin vetëm bazuar në të dhënat që disponoja, që ishin të paplota. Duke zbritur nga paga bruto tatimin mbi të ardhurat dhe sigurimet shoqërore, kam marrë pagë neto për muajin janar në masën të paktën 7.155 lekë, ndërsa për periudhën shkurt – dhjetor 1994 të ardhura neto në masën të paktën 9.792 lekë/muaj.*

*Gjatë gjithë vitit 1994 kam siguruar të ardhura neto nga puna si hetues në Prokurorinë Gramsh në vlerën prej 114.867 lekësh. Në periudhën janar – prill 1995, nga puna si hetues në Prokurorinë Gramsh kam siguruar të ardhura bruto (sipas vërtetimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, DRSSH-së Elbasan me nr. \*\*\*, datë 28.10.2016), në vlerën 49.875 lekë, që kanë rezultuar në të ardhura neto në vlerën prej 42.502 lekësh. Në total nga puna si hetues në Prokurorinë Gramsh për periudhën janar 1994 – prill 1995 kam siguruar të ardhura neto në vlerën 157.369 lekë”.*

4.12.1 Në përmbledhje të sa më sipër, kërkohet prej subjektit të rivlerësimit llogaritja e të ardhurave për periudhën 1989 – nëntor 1996, në vlerën 617.152 (gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

4.13 Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka kërkuar rishikimin e shpenzimeve jetësore familjare, në nivelin e 38% të të ardhurave, me arsyetimin si vijon: *“Mospërputhja e kontekstit tim me nivelin e përcaktuar të shpenzimeve jetësore 66%.*

- a) *Mospërputhjet gjeografike. Unë për të gjithë periudhën 1989 – 2016 kam banuar në Gramsh dhe kostoja e jetesës është ndjeshëm më e ulët sesa në Tiranë apo Elbasan, për shkak se një seri shërbimesh nuk është e nevojshme të kryhen ose nuk ofrohen, si dhe niveli i çmimeve për produktet e prodhimit vendas është më i ulët se në to. Po ashtu, edhe çmimi i shërbimeve të ndryshme është minimalisht 8, sa 1/2 e çmimeve në Tiranë apo Elbasan. Kjo provohet edhe nga të dhënat statistikore të INSTAT-it.*
- b) *Përbërja familjare. Shpenzimet janë marrë në masën 66% të të ardhurave, pa marrë parasysh përbërjen e familjes time. Në këtë periudhë kam pasur këtë përbërje: 1 anëtar nga janari 1994 deri në 26 janar 1997.*
- c) *Duke marrë në konsideratë faktorin gjeografik dhe përbërjen familjare, që janë faktorë thelbësorë në përcaktimin e nivelit të shpenzimeve të jetesës, shpenzimet e mia të jetesës në periudhën 1994 – 1999 nuk mund të jenë më të larta se 38%. Shpenzimet duhen llogaritur në raport me numrin e anëtareve të familjes”.*

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

4.14 Në vlerësim të fakteve të rezultuara gjatë hetimit, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, argumenteve të përdorura dhe dokumentacionit shoqëruar, Komisioni arsyeton se:



4.14.1 Së pari, lidhur me të ardhurat e tij deri në vitin 1994, kur ka filluar punë si hetues në Gramsh, shpjegimet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit janë mbështetur me dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e dokumentuar nga Drejtoria Arsimore Gramsh. Këto të ardhura janë në vlerën 48.694 (dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë deri në vitin 1994 (kur fillon punë si hetues).

Lidhur me këto të ardhura, Komisioni ka vlerësuar të mos i marrë në konsideratë si kursim për shkak të pagës së ulët, e cila varion rreth 1.401 (një mijë e katërqind e një) lekë/muaj për periudhën gusht '89 – dhjetor '93 dhe inflacionit të lartë të asaj periudhe, e cila nuk lejonte mundësi për kursim. Po ashtu, fakti se në vitin 1994 familja e tij (pjesë e të cilës ishte edhe subjekti rivlerësimit) ka marrë një kredi për blerje minitraktori për punime në fshat nga anëtarët e saj, provon se ata nuk kanë pasur mundësi kursimi deri në atë kohë, prandaj nuk e pranon kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke mos llogaritur në analizën financiare kursime për këtë periudhë.

4.14.2 Së dyti, lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi llogaritjen e shpenzimeve në masën 38% deri në periudhën që ka qenë 1 person në përbërjen familjare dhe me argumentin e vendndodhjes gjeografike (zonë malore), Komisioni arsyeton se nga të ardhurat për periudhën 1994 – prill 1995, në vlerën rreth 153.703 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë të ardhura, të ardhurat mujore janë rreth ose 10.247 (dhjetë mijë e dyqind e dyzet e shtatë) lekë/muaj dhe 38% i korrespondojnë vlerës prej 3.894 (treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekësh ose 130 (njëqind e tridhjetë) lekë/ditë. Komisioni vlerëson se subjekti ka jetuar në shtëpinë e prindërve dhe përveç shpenzimeve për të jetuar i është dashur të udhëtojë çdo ditë për në Gramsh, si dhe të paguajë për kredinë e marrë (sipas deklarimeve të vetë subjektit në DIPV dhe në Deklaratën *Vetting*) dhe, për pasojë, vlera prej 84 (tetëdhjetë e katër) lekësh nuk është logjikisht e pranueshme nga Komisioni, ndaj i qëndron standardit të shpenzimeve në masën 66%, duke mos e pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit.

4.14.3 Së treti, për periudhën prill 1995 – nëntor 1996 subjekti i rivlerësimit ka marrë pagën si gjyqtar (kryetar gjykate) dhe ka jetuar një periudhë edhe në Gramsh me qira, prej muajit maj të vitit 1996 (sipas deklarimeve të subjektit). Të ardhurat kanë qenë në vlerën 383.049 (treqind e tetëdhjetë tre mijë e dyzet e nëntë) lekë, e cila korrespondon me rreth 19.152 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë/muaj ose rreth 638 (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë/ditë, e cila është një vlerë e konsiderueshme dhe për të cilën Komisioni vlerëson se logjikisht mund të aplikojë masën prej 38% të shpenzimeve të pretenduar nga subjekti rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë faktorin gjeografik (zonë malore) dhe atë të përbërjes familjare me 1 person. Komisioni, megjithëse pranon pretendimin e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve në masën 38% për këtë periudhë, referuar edhe të ardhurave të përfituara, e pranon atë me rezervë, pasi rezultojnë një sërë shpenzimesh të tjera të panjohura të mundshme për transport ditor, qira, apo pagesë kësti kredi, etj., nga subjekti i rivlerësimit, apo investime të mundshme prej tij në shtëpinë e prindërve në fshat, të trajtuar më lart.

4.14.4 Për shkak të kohës së largët, mungesës së dokumentacionit provues dhe jetës modeste të subjektit të rivlerësimit, Komisioni pranon të konsiderojë si kursim prej tij shumat nga përllogaritjet e arsyetuara më lart [0 (zero) kursime deri në vitin 1994, 34% kursime për periudhën janar 1994 – prill 1995 dhe 62% kursime për periudhën maj 95 – nëntor 1996]. Kjo llogaritje është bërë në funksion edhe të të ardhurave të përfituara nga subjekti rivlerësimit.

4.14.5 Së katërti, lidhur me shumën prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh të deklaruar nga subjekti si të përdorur për blerjen e pasurisë apartament me burim nga shitja e minitraktorit, Komisioni vlerëson se nuk ka asnjë dokumentacion provues dhe se shpjegimet e subjektit nuk e bindën trupin gjykues për ekzistencën e kësaj shume. Pamundësia e subjektit rezultoi lidhur me ekzistencën e marrjes si dhe shlyerjes së kredisë, por asnjë provë apo dokument i kohës nuk është paraqitur për të provuar ekzistencën e shumës së pretenduar e se për Komisionin nuk duket bindëse (për gjithë arsyetimin e dhënë edhe nga vetë subjekti) se ai ka marr kundërvleftën e pretenduar nga shitja e minitraktorit. Shpjegimet e subjektit ishin të ndryshme gjatë deklarimeve periodike, Deklaratës *Vetting* dhe atyre të dhënë me prapësimet pas rezultateve të hetimit.

4.15 Në përfundim lidhur me këtë pasuri, Komisioni vlerëson se është blerë gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës dhe subjekti rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për blerjen e saj në nëntor të vitit 1996 në qytetin e Gramshit, në total shumën 130.251 (njëqind e tridhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë.

Tabela përmbledhëse, vitet 1989 – 11.1996

Të ardhurat kumulative	609.585
Shpenzime kumulative	319.836
<b>Mundësia për kursime deri më 11.1996</b>	<b>289.749</b>
Pasuri e blerë, apartament	420.000
<b>Rezultati</b>	<b>-130.251</b>

**5. Ndërtim informal me sip. 68 m<sup>2</sup>, në apartamentin e banimit me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, në Gramsh,** deklaruar për legalizim me nr. \*\*\*, datë 19.12.2014, nga bashkëshortja e subjektit, znj. T. A.. Vlera e deklaruar e investimit: 900.000 (nëntëqind mijë) lekë.

5.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2012 ndërtimin e këtij objekti informal (si shtesë) në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, i cili ndodhej në fazën e karabinasë dhe suvatimit.

5.2 Në Deklaratën e Pasurisë *Vetting*, subjekti e deklaroi këtë pasuri ende të papërfunduar dhe deklaruar për legalizim, me nr. \*\*\*, datë 19.12.2014, nga bashkëshortja T. A..

5.3 Drejtoria Vendore Elbasan e ASHK-së konfirmon për Komisionin<sup>11</sup> se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit rezulton aplikuese në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale me formularin e vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2014, në qytetin e Gramshit.

5.4 Nga dokumentacioni rezulton se:

- Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka aplikuar për legalizimin e këtij ndërtimi informal në vitin 2014, duke deklaruar se është kryer në periudhën 1997 – 2005.
- Në vitin 2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me aplikimin nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2015, deklaroi ndërtimin e këtij objekti informal në qershor të vitit 2012.

5.5 Në dokumentacionin e dosjes së ILDKPKI-së konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar<sup>12</sup> në vitin 2015 se ndërtimi i objektit është kryer në vitin 2012, ku e ka konsideruar deklarimin pararendës si një gabim teknik/lapsus.

5.6 Drejtoria Vendore Elbasan e ASHK-së konfirmon për Komisionin<sup>13</sup> se edhe banorët e tjerë të pallatit kanë aplikuar në procesin e legalizimit për shtesat përkatëse, si dhe ka dërguar kopje të dokumentacionit për secilin prej tyre. Nga dokumentacioni i dërguar rezulton se:

- Shtetasi A. H., banor i katit përdhe, ka aplikuar në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale me formularin e vetëdeklarimit, datë 15.11.2006, por nuk ka të përcaktuar kohën e kryerjes së ndërtimit.
- Shtetasi A. K., banor i katit të parë, ka aplikuar në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale me formularin e vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2014, duke deklaruar se ndërtimi është kryer në prill të vitit 2012.
- Shtetasi I. Sh., banor i katit të dytë, ka aplikuar në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale me formularin e vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2014, duke deklaruar se ndërtimi është kryer në prill të vitit 2012.

5.7 I pyetur nga Komisioni<sup>14</sup> lidhur me shtesën pa leje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Lidhur me shtesën pa leje në Gramsh ju bëj me dije se ajo është ndërtuar në vitin 2012, në muajin qershor, me sa më kujtohet. Ka qenë gabim i bashkëshortes sime deklarimi së është ndërtuar në vitin 1997. Kur ka bërë deklarimin, me sa më ka thënë, i kanë rekomanduar të bëjë një deklarim të tillë. Pasi jam vënë në dijeni i kërkoja të bëjë korigjimin dhe ajo e ka bërë duke lëshuar edhe një Deklaratë Noteriale. Gjithashtu, është bërë edhe një deklarim tjetër që është përfshirë në të njëjtën dosje mendoj ku është saktësuar koha e ndërtimit. Fakti që shtesa është ndërtuar në vitin 2012 provohet nga ortofotot digjitale të viteve 2007 dhe 2015 të zonës që përmban banesën. Në ortofoton digjitale të vitit 2007 ajo nuk pasqyrohet, ndërsa në ortofoton digjitale të*

<sup>11</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, të Drejtorisë Vendore Elbasan e ASHK-së.

<sup>12</sup> Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2015.

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, të Drejtorisë Vendore Elbasan e ASHK-së.

<sup>14</sup> Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit datë 2.3.2020.

viti 2015 pasqyrohet, çka tregon se është ndërtuar mes viteve 2007 e 2015. Provë tjetër që e vërteton ndërtimin në vitin 2012 është ankesa ime e depozituar në Bashkinë Gramsh, që është protokolluar në vitin 2012, një kopje të së cilës ua paraqes. Gjithashtu ju paraqes edhe një shkresë të Bashkisë Gramsh për kërkim dokumentacioni për këtë shkresë dhe kthimin e përgjigjes nga unë dhe bashkëshortja ime”.

5.8 Në vijim, lidhur me kohën e ndërtimit të objektit informal, subjekti deklaron: “Në maj a qershor u ndërtuan vetëm 6 kolona, trarët dhe soleta, ndërsa në muajt tetor e nëntor muret dhe pjesërisht suvatimet”.

5.9 Në mbështetje të shpjegimeve të paraqitura, lidhur me kohën e kryerjes së ndërtimit të objektit informal, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2012, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Gramsh dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor pranë kësaj bashkie, ndaj fillimit të ndërtimit pa leje nga pronari i apartamentit në katin përdhe të pallatit, duke iu kërkuar ushtrimin e kompetencave sipas ligjit për të penguar ndërtimin. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në ankesë, shprehet si vijon: “Ju bëj me dije se mosveprimi juaj në zbatim të detyrimeve ligjore përbën shpërdorim detyre. Nëse Ju nuk do të veproni në përputhje me ligjin do të bëj denoncim penal për shpërdorim detyre kundër Jush dhe do t’i drejtohem organeve më të larta”.

b) Kërkesën për dokumentacion nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2013, të Bashkisë Gramsh drejtuar subjektit të rivlerësimit, ku i kërkohet të paraqesë dokumentacion lidhur me ndërtimin ose shtesën e kryer pa leje, brenda datës 5.12.2013.

c) Përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2013, të subjektit të rivlerësimit drejtuar Bashkisë Gramsh lidhur me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2013, ku e njofton që nuk mund të vërë në dispozicion asnjë dokumentacion për ndërtimin pa leje dhe tërheq vëmendjen se nuk ka qenë dakord për kryerjen e ndërtimit dhe ka njoftuar Bashkinë Gramsh për ta ndaluar këtë ndërtim, por nga ana e Bashkisë nuk u mor asnjë masë.

5.10 Lidhur me vlerën e ndërtimit të objektit informal, Komisioni ka kërkuar<sup>15</sup> nga subjekti i rivlerësimit të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor preventiv/situacion për ndërtimin e shtesës me sip. 68 m<sup>2</sup>, në Gramsh, në vitin 2012, të deklaruar në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë.

5.11 Për vlerën e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e objektit informal, subjekti ka paraqitur një preventiv të ndërtesës të kryer në datën 23.3.2020, nga një inxhinier ndërtimi, i licencuar si vlerësues pasurish të paluajtshme. Në relacionin e vlerësuesit të përgatitur në vitin 2020 vlera e shtesës është nxjerrë 835.523 (tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë. Në relacionin e tij, vlerësuesi shpjegon se zërat dhe volumet e punës të kryera janë llogaritur sipas sqarimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, pasi në momentin e vlerësimit shtesa ka përfunduar.

5.11.1 Subjekti i rivlerësimit shprehet se u ka paguar personave që ndërtuan pjesën e themeleve shumë prej 54.200 (pesëdhjetë e katër mijë e dyqind) lekësh, si dhe ka paguar një shumë prej 5.000 (pesëqind mijë) lekësh për prishjen e ballkonit të apartamentit ekzistues dhe heqjen e mbeturinave të tij, të cilat nuk janë përfshirë në preventiv, pasi nuk janë pjesë e vlerës. Gjithë vlera e shtesës shkon në 895.723 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë [835.523 (tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë + 54.200 (pesëdhjetë e katër mijë e dyqind) lekë + 5.000 (pesë mijë) lekë].

5.12 Në dokumentacionin e dërguar nga Drejtoria Vendore Elbasan e ASHK-së gjenden foto të objektit të shtesës informale, të depozituara nga bashkëshortja e subjektit pranë ALUIZNI-t Elbasan, për procesin e legalizimeve në datën 19.12.2014. Nga vëzhgimi i tyre rezulton se shtesa është thuarje e përfunduar.

5.13 Meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për vlerën e këtij ndërtimi informal, në kohën e kryerjes së tij, Komisioni i është referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”, ku rezulton se kostoja mesatare e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave për sipërfaqen e ndërtimit në qytetin e Gramshit është 29.461 (njëzet e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një) lekë/m<sup>2</sup>, nga ku rezultoi se kostoja e shtesës pa leje me sip. 68 m<sup>2</sup>, të subjektit të rivlerësimit ka qenë mesatarisht në vlerën 2.003.348 (dy milionë e tre mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë. Nëse kësaj kostoje do t’i zbrisnim vlerën e TVSH (20%), si dhe fondin rezervë (5%), në total 25%, vlera shkon në 1.502.511 (një milion e pesëqind e dy mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë (duke mbajtur në konsideratë shpjegimet e subjektit se punimet janë kryer me grupe pune të herëpashershme, po jo me fatura me TVSH.

<sup>15</sup> Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësorin e datës 2.3.2020.

5.14 Lidhur me këtë pasuri rezulton:

- a) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësor janë kontradiktore gjatë vitit 2012, kur është ndërtuar ky objekt, duke e ndryshuar mes muajit qershor dhe tetor të vitit 2012.
- b) Në dokumentacionin e dërguar nga Drejtoria Vendore Elbasan e ASHK-së, rezulton se objekti informal është deklaruar i ndërtuar në qershor të vitit 2012. Gjithashtu, edhe banorët e tjerë që kanë kryer shtesa informale në këtë objekt e kanë deklaruar kryerjen e ndërtimit në prill të vitit 2012.
- c) Në analizën financiare është marrë në konsideratë ndërtimi i këtij objekti informal deri në qershor të vitit 2012, sipas Deklaratës së datës 30.9.2015, për përfshirjen në procedurat e legalizimit pranë drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan.
- ç) Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në vlerën 1.085.407 (një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatë) lekë për të ndërtuar shtesën me sip. 68 m<sup>2</sup> në qershor të vitit 2012, duke e referuar si vlerë të ndërtimit sipas kostove të EKB-së për vitin 2011.
- d) Në rast se marrim në konsideratë vlerën e kostos së ndërtimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, ai është në pamundësi financiare për të ndërtuar këtë shtesë në vlerën 482.896 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.
- dh) Duket se edhe vetë subjekti i rivlerësimit ka kryer një ndërtim informal, me gjithë ankesat që kishte në raport me legjislacionin në fuqi.

5.14.1 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

5.15 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Kam deklaruar në Deklaratën Vetting shtesë pa leje në Gramsh, në banesën e blerë në vitin 1996, me sip. 68 m<sup>2</sup>, ndërtim i papërfunduar, i deklaruar për legalizim me nr. \*\*\*, datë 19.12.2014, nga bashkëshortja T. A.. Shpenzuar për ndërtimin e karabinasë dhe suvatime në shumën 900.000 lekë. Shuma e përdorur për ndërtim siguruar nga paga jone si bashkëshorte. Është e palegalizuar ende dhe bashkëpjesëtarë jemi unë dhe bashkëshortja. Në këtë deklaram nuk kam përcaktuar muajin kur janë kryer punimet, pasi deklarimi nuk e kërkonte këtë.*

*Në DVP-në e vitit 2012 kam deklaruar shtesë banese në banesën 1+1 në pallatin 150, Gramsh, me sip. rreth 70 m<sup>2</sup>, ndërtuar deri në fazën e karabinasë + suvatime në tetor të vitit 2012. E paregjistruar në regjistrat publikë. Ndërtuar me të ardhura nga paga dhe kursime të mëparshme (huaja në shumën 300.000 lekë e kthyer nga P. B. në tetor të vitit 2013). Sikundër shihet nga ky deklaram, i bërë për herë të parë edhe para se bashkëshortja të bënte vetëdeklarimin, kam përcaktuar si kohë të ndërtimit muajin tetor të vitit 2012. Ka një pasaktësi me deklarimin që kam bërë në përgjigje të pyetësorëve Tuaj, ku kam deklaruar se është ndërtuar në muajt tetor - nëntor të vitit 2012. Po unë me datë të saktë nuk e mbaj mend kur ka përfunduar e parë e ndërtimit (akoma pa përfunduar komplet), por ka qenë fundi i muajit tetor apo fillimi i nëntorit. Megjithatë për efekt të llogaritjeve të merret fundi i muajit tetor të vitit 2012”.*

5.16 Subjekti ka kërkuar marrjen e vlerës prej 900.000 (nëntëqind mijë) lekësh, si kosto ndërtimi dhe pranimin e aktit të vlerësimit nga eksperti vlerësues i licencuar, F. S., vlerësim i cili është bërë mbi bazë punimesh faktike në bazë të çmimeve të miratuara me akte të qeverisë shqiptare.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

5.17 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit, pasi vlerësoi faktet dhe provat e paraqitura nga subjekti, si dhe rrethanat e çështjes, arsyeton se:

a) Lidhur me kohën e ndërtimit, shpjegimet e subjektit mbështetur në prova dhe fakte, janë në vetvete disi kontradiktore, pasi në vitin 2014 personi i lidhur me të/bashkëshortja ka deklaruar pranë ALUIZNI-t se ndërtimi është kryer në periudhën 1997 – 2005. Në vitin 2015 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me aplikimin nr. \*\*\*\* prot., datë 30.9.2015, deklaroi ndërtimin e këtij objekti informal në qershor të vitit 2012, duke e konsideruar deklarimin pararendës një lapsus. Në analizë të këtyre deklarameve, ai i kryer pranë ALUIZNI-t është më vonë në kohë se ai në DIPV-në e vitit 2012, plotësuar dhe dorëzuar në vitin 2013.

b) Lidhur me vlerën e ndërtimit, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor të kohës, preventiv/situacion për ndërtimin e shtesës. Lidhur me aktin e vlerësimit të depozituar nga subjekti i

rivlerësimit, rezulton se është kryer në vitin 2020 dhe sipas këtij akti zërat dhe volumet e punës të kryera janë llogaritur sipas sqarimeve dhe shpjegimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, pasi në momentin e vlerësimit shtesa ka përfunduar, prandaj nuk mund të pranohet nga Komisioni si provë.

c) Trupi gjykues i Komisionit ka pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për llogaritjen e vlerës së ndërtimit në koston e karabinasë, për sa kohë që kjo situatë provohet edhe me fotot e paraqitura pranë ALUIZNI-t në momentin e plotësimit të formularit/kërkesës për legalizim.

5.18 Duke përlllogaritur koston e ndërtimit për karabina, sipas EKB-së për vitin 2012, në masën 70%, zbritur vlerën e TVSH (20%), si dhe fondin rezervë (5%), në total 25%, pra, duke pranuar shpjegimet e subjektit se punimet janë kryer me grupe pune të herëpashershme, po jo me fatura me TVSH, vlera e ndërtimit/objektit shkon në 1.051.757 (një milion e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë. Në përfundim, duke qenë se ndërtimi është bërë brenda vitit kalendarik, trupi gjykues ka vlerësuar ta llogarisë në dy variante, duke arsyetuar se pretendimi i subjektit për kryerjen e punimeve deri në tetor të vitit 2012 lidhet me kthimin e një shumë huaje, veprime këto që në tërësinë e tyre krijojnë dyshime mbi besueshmërinë. Lidhur me vlerën prej 30% për përfundimin e këtij objekti, ai është deklaruar se ka përfunduar në vitin 2019 dhe i përket një periudhe jashtë Deklaratës *Vetting* dhe, për pasojë, nuk është përfshirë në analizën financiare, duke e konsideruar si ndërtim të papërfunduar deri në datën e deklarimit në Deklaratën *Vetting*.

5.19 Subjekti rezulton në pamjaftueshmëri financiare për realizimin e kësaj shtese, sipas tabelës në vijim.

Analizë	24 janar 2012	24 janar – 30 qershor 2012 (vlera sipas EKB-së)	24 janar – 30 qershor 2012 (vlera e deklaruar nga subjekti)	24 janar – 30 tetor 2012 (vlera sipas EKB-së)
Blerë automjet tip "Volkswagen"	501.660			
Ndërtuar banesë informale	0	1.051.757	900.000	1.051.757
Arkëtuar hua nga debitori P. B.		0	0	0
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	-412.621	272	272	272
Të ardhura nga punësimi i subjektit dhe bashkëshortes	123.399	649.956	649.956	1.254.281
Shpenzime jetese	46.516	232.580	232.580	418.644
<b>Rezultati</b>	<b>-12.156</b>	<b>-634.653</b>	<b>-482.896</b>	<b>-216.392</b>

**6. Apartament banimi, me sip. 88.77 m<sup>2</sup>, në Gramsh,** blerë me Kontratën e Blerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2010, në shumën 3.000.000 (tre milionë) lekë, nga bashkëpronarët Sh. T., etj., që e kanë blerë në procesin e privatizimit të banesave shtetërore. Në bashkëpronësi me bashkëshorten nga 50%. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të ardhurat nga paga e bashkëshortëve dhe kursimet e viteve të mëparshme.

6.1 Zyra Vendore Gramsh e ASHK-së konfirmon për Komisionin<sup>16</sup> këtë pasuri, të llojit "apartament", me sip. 88.77 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lagjia "\*\*\*\*", pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati i dytë, apartamenti nr. \*\*\*, Gramsh, përfituar me aktin noterial Kontratë Shitjeje, në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë.

6.2 Për blerjen e pasurisë apartament janë tërhequr përkatësisht: (a) në datën 23.4.2010, tërhequr *cash* fondet në vlerën 1.756.169 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë në "OTP Bank" nga bashkëshortja e subjektit, znj. T. A., si pasojë e mbylljes së depozitës me vlerë fillestare 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, hapur në datën 13.7.2009; (b) në datën 23.4.2010, tërhequr *cash* fondet në vlerën 545.325 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë në "OTP Bank", si pasojë e mbylljes së depozitës me vlerë fillestare 454.000 (katërqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë, hapur në datën 27.12.2005, nga bashkëshortja e subjektit, znj. T. A.; (c) shuma prej 1.336.789 (një milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh ka burim të ardhurat nga pagat e vitit dhe pakësimi i gjendjes *cash* në banesë në vitin 2010.

6.3 Nga analiza financiare dhe verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, rezulton se subjekti ka teorikisht mundësi financiare të shtojë vlerën *cash* në banesë me të ardhurat nga paga e vitit 2008 dhe nga mbyllja e depozitave bankare përgjatë vitit 2008 dhe se kjo përputhet

<sup>16</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.01.2021 të Zyrës Vendore Gramsh të ASHK-së

edhe me deklarimin e tij në DIPV, por nuk duket bindës fakti se përse është mbajtur një vlerë e lartë e gjendjes *cash* në banesë, e cila është riinvestuar në depozitë bankare në korrik të vitit 2009, duke humbur interesin e përfituar në rast se kjo shumë do të ishte mbajtur gjatë gjithë kësaj periudhe në depozitë bankare, nisur edhe nga interesi i shtuar i subjektit për kryerjen e këtyre veprimeve (huadhënie me interes) dhe se logjika nuk duket ekonomike.

6.4 Në përfundim, lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë apartament, nga hetimi rezulton se periudha kur janë tërhequr fondet *cash* nga bashkëshortja e subjektit nga llogaritë e saj bankare përkon me periudhën kur është blerë apartamenti me sip. 77 m<sup>2</sup>, me Kontratë Shitblerjeje, datë 26.4.2010.

6.5 Nga analiza financiare rezulton se në datën 26.4.2010, subjekti i rivlerësimit ka të ardhura me burime të ligjshme për të blerë këtë pasuri, duke marrë në konsideratë në analizën financiare çmimin e deklaruar nga subjekti rivlerësimit sipas Kontratës së Shitblerjes.

**7. Automjet tip “Volkswagen”, me targa \*\*\***, viti i prodhimit 2003, blerë në datën 24.1.2012, në Itali, për llogari të subjektit nga motra e tij rezidente në Itali, në shumën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro dhe së bashku me doganën dhe transportin shkon në shumën 3.600 (tre mijë e gjashtëqind) euro. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të ardhurat e siguruar nga pagat e tij dhe e bashkëshortes.

7.1 Lidhur me këtë pasuri, DRSHTRR-ja<sup>17</sup> konfirmon për Komisionin regjistrimin e automjetit me targa \*\*\*, në emër të subjektit të rivlerësimit, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e plotë të tij.

7.2 Sipas dokumentacionit rezulton se:

a) Ky automjet ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga pika doganore “Durrës”, në datën 1.2.2012, me targa \*\*\*, nga subjekti i rivlerësimit, të cilit i është shitur nga shtetësja V. T. M. me Deklaratën e datës 24.1.2012, në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro. Në bazë të kursit të këmbimit të monedhës euro në lekë të Bankës së Shqipërisë për muajin shkurt të vitit 2012<sup>18</sup>, vlera e automjetit, së bashku me TVSH-në e paguar në doganë dhe shpenzimet e transportit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit ishte 501.660 (pesëqind e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë [3.600 (tre mijë e gjashtëqind) euro x 139,35 (njëqind e tridhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë].

b) Certifikata e mëparshme e pronësisë së automjetit tregon se vendi i origjinës ka qenë Italia.

c) Sipas Deklaratës Doganore, datë 2.2.2012, automjeti është deklaruar në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro dhe vlera statistikore e përcaktuar është 488.369 (katërlekë. Mbi vlerën statistikore të automjetit është paguar dhe TVSH-ja në shumën 97.673 lekë. Vlera statistikore e automjetit së bashku me TVSH-në e paguar në doganë ishte 586.042 lekë (488.369 lekë + 97.673 lekë).

7.3 Referuar dokumentacionit të mësipërm, nga Komisioni ngrihen dyshime lidhur me vlerën reale të blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit, pasi çmimi i blerjes së tij është më i ulët se vlera statistikore, plus shpenzimet e kryera në doganë.

7.4 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit është kryer analiza financiare në datën 24.1.2012, nga e cila subjekti rezulton në pamjaftueshmëri financiare për të blerë këtë automjet në vlerën 327.156 (treqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

7.5 Komisioni i kaloi subjekt të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar lidhur me çmimin e blerjes dhe shkaqet e një çmimi më të ulët, e mundësitë financiare me burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në datën 24.1.2012.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

7.6 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon: “... për sa i përket çmimit, mund të jetë nën mesataren, pasi nuk është blerë në shoqëri që tregtojnë automjete, por është blerë nga një shtetas italian. Atë mjet e ka gjetur motra ime (banuese e përhershme në Itali) pas kërkimit për një kohë të gjatë disamujore në internet. Unë kam kërkuar një mjet me karakteristika mesatare të asaj marke, si makinë familjare dhe ekonomike, por edhe me çmim të lirë. Duke qenë se u përputhën mundësitë financiare të miat me çmimin e ofruar, vendosa ta blej atë. Çmimi është nën mesataren, por kjo nuk do të thotë se nuk është

<sup>17</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 06.02.2020

<sup>18</sup> Sipas faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë kursi zyrtar i këmbimit të monedhës euro në lekë për muajin shkurt të vitit 2012 ka qenë rreth 139,35 (njëqind e tridhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë. ([https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_të\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_të_kembimit/)).

*real, pasi mesatarja është pasojë e çmimeve nën dhe mbi të. Këtu çmimet e tregut ishin pak më të larta, pasi krahas kostove të blerjes dhe transportit, përfshinin edhe fitimin që realizonin tregtarët. Nëse do llogaritej fitimi i tregtarit, çmimi do t'i afrohej mesatares. Nga një konstatim i shpejtë, pas kërkimit në internet në datën 20.3.2011, një mjet i ngjashëm me mjetin që kam blerë unë sot shitet nga 500 euro në Gjermani”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

7.7 Pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti rivlerësimit, si dhe sistemimit të gjendjes *cash*, e reflektuar në zërin “pakësime likuiditetesh”, ka ndryshuar situata negative financiare në vlerën 12.216 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

**8. Automjeti tip “Rover”, me targa \*\*\*, në përdorim nga viti 2009 deri në vitin 2012, në pronësi të motrës së subjektit, B. A..**

8.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të drejtën e përdorimit të këtij automjeti, në pronësi të motrës së tij, në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2009, si dhe pagesën nga ana e tij të taksës doganore në masën 255.321 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e një) lekë dhe taksës së regjistrimit në masën 26.500 (njëzet e gjashtë mijë e pesëqind) lekë.

8.2 Në Deklaratën e Interesave Private Vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në masën 100.000 (një milion) lekë nga shitja e këtij automjeti në pronësi të motrës, me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.7.2012. Subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e automjetit u mbajtën prej tij, pasi shpenzimet e regjistrimit në vitin 2009 ishin paguar nga ai.

8.3 Lidhur me këtë automjet, DRSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021, konfirmon për Komisionin se mjeti me targa \*\*\* aktualisht figuron i regjistruar në emër të shtettes A. M., me targa \*\*\*, duke vënë në dispozicion praktikën.

8.4 Sipas dokumentacionit rezulton se:

a) Automjeti i tipit “Rover” është regjistruar fillimisht në emër të motrës së subjektit të rivlerësimit, me targa \*\*\*.

b) Automjeti është shitur me Kontratën nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 12.7.2012. Në këtë kontratë subjekti i rivlerësimit ka qenë përfaqësues me prokurë i motrës së tij. Vlera e shitjes së automjetit ka qenë 100.000 (një milion) lekë dhe është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

8.5 Nga dokumentacioni i dërguar nga ILDKPKI<sup>19</sup>-ja rezulton se subjekti i rivlerësimit është pajisur me Prokurën e Përfaqësimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.12.2008, nga motra e tij B. A., duke pasur të drejtë mbi automjetin tip “Rover” për ta përdorur, shitur ose për ta dhuruar tek të tretë ose vetes së vet, të kryejë të gjitha veprimet në drejtorinë e doganave për të shlyer detyrimet përkatëse, si dhe të kryejë të gjitha veprimet pranë DPSHTRR-së për regjistrimin e automjetit. Sipas Deklaratës Doganore të datës 6.1.2009, për këtë automjet janë paguar detyrime doganore në masën 281.821 (dyqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e një) lekë.

8.6 Subjekti i rivlerësimit sqaron për Komisionin<sup>20</sup> se motra e tij kishte sjellë nga jashtë automjetin tip “Rover”, të cilin ia kishin dhuruar disa të njohur të saj në Portugali. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse automjeti do t'i pëlqente do ta blinte dhe për këtë arsye motra i kishte lëshuar edhe prokurë për ta përdorur apo tjetërsuar. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se automjeti ishte jo ekonomik dhe për këtë arsye nuk e bleu, por e ka përdorur vetëm në disa raste (jo më shumë se 10 herë për udhëtime Gramsh - Elbasan, apo Gramsh-Tiranë).

8.7 Nga verifikimi në Regjistrin Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm të AMF-së rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e përdoruesit të automjetit me targa \*\*\*, në policat e sigurimit për periudhën 6.8.2009 – 13.8.2012.

8.8 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka përfshirë në analizë financiare shpenzimet e deklaruara nga subjekti, si dhe ka marrë në analizë vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë të përfituar nga shitja e tij në vitin 2012, duke pranuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>19</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, të ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Shihni përgjigjen nr. 8, të pyetësorit, datë 8.1.2020.

## **9. Mjete monetare, depozita, llogari rrjedhëse të deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën totale prej 4.300.025 (katër milionë e treqind mijë e njëzet e pesë) lekësh**

9.1 Kursime të subjektit në shumën 2.500.482 (dy milionë e pesëqind mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendje në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”, dega Gramsh. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshorten. Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim krijimi të ardhurat nga paga e përfituar nga puna ndër vite si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, të patërhequra në vite.

9.2 Depozitë bankare në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë me afat 1-vjeçar, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në emër të subjektit të rivlerësimit, në bankën “Societe Generale Albania”, dega Gramsh, çelur në vitin 2015. Vlera e krijuar bashkë me shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës është 508.512 (pesëqind e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *Vetting*, deklaron si burim krijimi të ardhurat nga paga si bashkëshortë dhe kursimet e mëparshme.

9.3 Depozitë bankare në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në bankën “Societe Generale Albania”, dega Gramsh, çelur në vitin 2013. Vlera e krijuar bashkë me shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës është 536.262 (pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *Vetting*, deklaron si burim krijimi të ardhurat nga paga si bashkëshortë dhe kursimet e mëparshme.

9.4 Depozitë bankare në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bankën “Societe Generale Albania”, dega Gramsh, çelur në vitin 2013. Vlera e krijuar bashkë me shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës është 848.730 (tetëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *Vetting*, deklaron si burim krijimi të ardhurat nga paga si bashkëshortë dhe kursimet e mëparshme.

**9.5 Nga hetimi i llogarive ka rezultuar se janë krijuar me të ardhura nga pagat, por edhe nga derdhje *cash*, të cilat e kanë burimin sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit nga gjendjet *cash* të mbajtura prej tij në banesë apo të ardhurat nga huadhëniet që, gjithashtu, janë trajtuar nëpërmjet marrëdhënieve individuale dhe *cash* (të poshtëtrajtuara).**

9.6 Në përfundim të hetimit administrativ rezulton se këto pasuri janë krijuar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, si dhe nga shuma të derdhura *cash* prej tyre, për të cilat subjekti ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të tyre në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

9.7 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurive monetare të deklaruar, 1 në formën e llogarisë rrjedhëse dhe 3 në formën e depozitës bankare, në vlerën 4.300.025 (katër milionë e treqind mijë e njëzet e pesë) lekë, subjektit i ka kaluar barra e provës së bashku me analizën financiare për vitet 2003 – 2016, e pasqyruar më poshtë në vendim, si dhe gjatë trajtimit të marrëdhënieve të huadhënies.

**10. Të ardhura në shumën 957.120 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë, të përfituara nga ekzekutimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 29.1.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, në vitin 2009, si shpërblim dëmi nga mosrespektimi i kontratës së huas nga shtetasi H. B..**

10.1 Subjekti i rivlerësimit, me kontratën e huas së datës 1.5.2002, i ka dhënë hua<sup>21</sup> shtetasit H. B., shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD me interes 10% në vit, me dorëzanës shtetasin K. Ç..

10.2 Nga subjekti është ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, ku kërkon shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i Kontratës së Huas së datës 1.5.2002, në masën 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë dhe interesit 10% të detyrimit të arritur të pashlyer.

10.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit, sqaron: “*Ishte gabim dhënia e asaj huaje. H. B. ishte një mashtrues, por për fat të mirë shumat e marra hua nuk i shpenzoi kot, por ndërtoi një ndërtesë. E them ishte mashtrues, pasi edhe një personi tjetër në Gramsh, A. K., i kishte marrë gati në të njëjtën periudhë hua një*

<sup>21</sup> Shihni përgjigjen nr. 3 dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin e datës 15.1.2021.



*shumë mjaft të madhe dhe megjithëse kaluan vite nuk ia ktheu. Di që edhe ky person ka zgjidhur gjyqësisht konfliktin dhe është në procedurë ekzekutimi”.*

10.4 Me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.1.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh është vendosur ekzekutimi/pagimi i vlerës prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh deri në datën 31.12.2007 dhe për çdo ditë vonesë detyrimin e të paditurit të paguajë kamatëvonesat ndaj subjektit të rivlerësimit (paditësi). Ky vendim nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 5.2.2021.

10.5 Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 29.1.2007 të kësaj gjykate, palët, gjatë shqyrtimit, vendosën ta zgjidhin me pajtim mosmarrëveshjen duke e konsideruar si pranim të padisë. Lidhur me këtë vendim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është lëshuar urdhërekzekutimi, i cili më pas është ekzekutuar nga Zyra Përmbartimore Gramsh duke shitur pasuritë e sekuestruara të huamarrësit dhe duke kaluar shumën 2.423.336 (dy milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në llogarinë e subjektit.

10.6 Nga analiza e llogarive bankare rezulton se vlera 2.423.336 (dy milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë nuk është kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit nga llogaria e përmbartuesit gjyqësor, por është derdhur *cash* nga ky i fundit.

10.7 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>22</sup> lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga interesi i fituar nga huaja dhënë shtetasit H. B., shprehet si vijon: *“Nuk më kujtohet saktë nëse e kam paguar apo jo tatimin mbi të ardhurat mbi shumën e përfutur në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm. Unë nuk kam ndonjë dokument që të provoj pagesën”.*

10.8 Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan<sup>23</sup> nuk konfirmon për Komisionin pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale nga interesi i huas dhënë shtetasit H. B. [llogaritur në shumën 957.120 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë].

10.9 Komisioni hetoi hidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të dhënë hua shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD (1.400.000 lekë) në vitin 2002, duke përgatitur analizën financiare sipas tabelës vijuese:

<i>Tabela Përmbledhëse - Prill 2002</i>	
Të ardhurat kumulative	3.390.576
Shpenzimet kumulative	2.486.217
Blerë apartament me sip. 52.8 m <sup>2</sup>	420.000
Hua e dhënë debitorit H. B.	1.440.000
<b>Rezultati</b>	<b>-955.641</b>

10.10 Nga rezultati i analizës financiare subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për të dhënë hua shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD ose 1.440.000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekë në datën 1.5.2002.

10.11 Nga dokumentacioni nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paguar tatim mbi të ardhurat personale të përfutura. Subjekti rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për dhënien e huas në vitin 2002, në shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD.

10.12 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar në formën e likuiditetit depozitë në vlerën 2.423.000 (dy milionë e katërqind e njëzet e tre mijë) lekë, të krijuar dhe deklaruar në vitin 2009. Duke qenë se kjo pasuri nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si e ardhur e krijuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën të jenë paguar detyrimet tatimore, sipas legjisllacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit, ajo nuk është përfshirë në analizën financiare dhe as llogaritur si burim për krijimin e pasurive të tjera në vitet 2010 dhe 2011.

<sup>22</sup> Shihni përgjigjen nr. 5, të pyetësorit datë 15.1.2021.

<sup>23</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të DRT-së Elbasan.

10.13 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë pasuri dhe burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave sipas detyrimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

10.14 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar sa vijon: *“Lidhur me huan dhënë H. B. unë deklaroj me përgjegjësi të plotë se kam pasur mundësi që deri në prillin e vitit 2002 të kursej shumë prej 1.440.000 lekësh. Siç kam argumentuar gjerësisht në seksionin I më sipër, në pikën I-2, shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – dhjetor 2001 nuk kanë qenë më të larta se 38% e të ardhurave. Për sa më sipër, unë kam pasur mundësi financiare mëse të mjaftueshme për dhënien e huas H. B. në prill të vitit 2002. Për këtë shkak të ardhurat janë nga burime të ligjshme dhe duhet të më njihet shuma e plotë e dhënë hua”.*

10.15 Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që pasi të saktësohet niveli i shpenzimeve jetësore para vitit 2002, sipas përbërjes familjare, vendbanimit dhe mënyrës së jetesës (referuar kërkesave të subjektit), të bëhet vlerësimi i saktë i mundësive financiare në prill të vitit 2002.

10.16 Në lidhje me pagimin e tatimit subjekti shpjegon për Komisionin sa vijon: *“Unë kam paguar rregullisht tatimin mbi të ardhurat personale për të gjithë periudhën që kam siguruar të ardhura të ndryshme nga interesat bankare (që janë mbajtur në burim) të ardhura nga huat apo qiraja, në kushtet kur nuk provohet se nuk e kam paguar tatimin mbi fitimin në vitin 2009 apo 2010, kërkoj nga ana juaj që duke vlerësuar të gjitha rrethanat, të pranoni pagesën e tatimit të bërë në vitin 2021 për këtë shumë dhe të pranoni si burim financiar të ligjshëm shumë prej 957.120 lekë”.* Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë urdhërpagesën për tatimin mbi të ardhurat personale dhe mandatpagesën për tatimin mbi të ardhurat personale datë 16.3.2021, në shumën 143.568 (njëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

10.17 Në vlerësim të rezultateve të hetimit, provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arsyeton si vijon:

10.17.1 Së pari, mbi burimin e të ardhurave të përdorura për dhënien e huas, Komisioni i ka llogaritur nga periudha dhjetor 1996 – prill 2002, duke llogaritur përkatësisht sipas përcaktimeve në pikën 4 të vendimit, duke i llogaritur në mënyrë të diferencuar fillimisht shpenzime për 2 persona, më tej pas lindjes së fëmijës së parë dhe shtuar të ardhurat e bashkëshortes si mësuese, shpenzimet janë llogaritur me 66% deri në dhjetor të vitit 1999 dhe për periudhën 2000 – prill 2002 janë llogaritur shpenzime sipas INSTAT-it (për frymë) duke zbritur -20% dhe duke e konsideruar Gramshin si zonë malore, duke e pranuar kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin shoqërues. Komisioni nuk ka llogaritur si shpenzim pagesa të mundshme për shlyerjen e kredisë apo shpenzime të tjera të panjohura. Analiza e kryer nga Komisioni është një llogaritje formale e të ardhurave minus shpenzimet minimale, pasi nuk ka deklarime të kohës (koha është e largët) dhe nuk ka ndonjë dokumentacion provues. Nga kjo analizë subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare në shumën prej 416.130 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) lekësh për dhënien hua të shumës së deklaruar dhe, për këtë, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se dhënia e saj nuk është nga burime të ligjshme.

10.17.2 Së dyti, lidhur me pagimin e tatimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar në deklaratën *Vetting* pagimin e tatimit mbi të ardhurat shtesë të përfituara dhe si rrjedhojë nuk ka dokumentuar ndonjëherë ndër vite (viti 2009 e në vijim) pagimin e tij. Detyrimi për pagimin e tatimit është një rregull i parashikuar në legjislacionin përkatës tatimor dhe kryhet mbi dokumentacionin (kontratë/marrëveshje/vendim), me të cilin është përfituar kjo e ardhur. Subjekti, në cilësinë e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë besohet se ka pasur dijeni se çdo e ardhur e përfituar duhet t’i nënshtrohet tatimit përkatës sipas ligjit dhe se nuk ka bërë ndër vite ndonjë përpjekje për plotësimin e këtij detyrimi, por ka e paguar atë vetëm për shkak të deklaratës *Vetting* dhe se forma me të cilën e ka paguar nuk është e njohur apo të legjitimohë një të ardhur të vitit 2009.

10.18 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhënien e kësaj huaje në vitin 2002 dhe se nuk ka paguar detyrimet përkatëse tatimore në vitin 2009 duke i shmangur ato. Trupi gjykues nuk ka njohur të ardhurat në vitin 2009 për krijim e depozitës, duke i konsideruar në kundërshtim me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni

ka vlerësuar në tërësi këtë huadhënie, veprimin e subjektit të rivlerësimit për dhënien e shumës me interes 10% një shtetasi (të pavlerësuar pozitivisht prej tij) dhe duke vepruar si tregtar, mënyrën e përfitimit të shumës 2.423.336 (dy milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë nëpërmjet gjykatave, mosveprimin e tij për pagimin e tatimit përkatës dhe paraqitjen e situatës si padijeni, krijon bindjen se janë në cenim të figurës së tij si gjyqtar.

**11. Interesa nga huadhënie e deklaruar nga subjekti në shumën 474.000 (katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë (interesa),** deri në janar të vitit 2017 [pa përfshirë vlerën 957.120 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë të trajtuar në pikën 10].

11.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* hua në shumën 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë, dhënë bashkëshortëve P. dhe A. B., sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2011, me afat 2-vjeçar, me interes 10.7%. Huaja vazhdon, ndonëse afati i kthimit ka skaduar në vitin 2013 dhe nga principlali është kthyer shuma 1.325.000 (një milion e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë dhe interesa për vonesën nga viti 2012 e vazhdim në shumën 304.000 (treqind e katër mijë) lekë, përfshirë vitin 2016. Nga huaja nuk është kthyer ende shuma prej 775.000 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekësh dhe interesat në masën 225.000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë.

11.1.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim për këtë huadhënie të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve dhe kursimet e mëparshme.

11.1.2 Sipas kontratës së huas<sup>24</sup>, huamarrësi do t'i kthente subjektit të rivlerësimit në total deri në datën 7.10.2013, shumën 2.325.000 (dy milionë e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë, me 3 këste, si vijon: (i) shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë në datën 7.10.2012; (ii) shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, në datën 7.4.2013; dhe (iii) shumën 1.125.000 (një milion e njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë në datën 7.10.2013.

11.1.3 Marrëdhënia e huas nuk është realizuar nëpërmjet sistemit bankar nga subjekti i rivlerësimit dhe arkëtimi i kësteve të deklaruar të paguara është kryer *cash* dhe jashtë sistemit bankar.

11.1.4 Nga analiza e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes vihet re se në datën 7.10.2011 janë tërhequr vlerat në lekë nga depozitat ekzistuese si vijojnë:

a) vlera 384.000 (treqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, tërhequr së bashku me interesin e përfituar deri në këtë datë, nga vlera e depozitës ekzistuese në emër të bashkëshortes me vlerë fillestare 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në “OTP Bank” sh. a. Në këtë datë depozita është rinovuar përsëri në emër të bashkëshortes në vlerën 1.200.000 lekë;

b) vlera 1.178.400 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë tërhequr së bashku me interesin e përfituar deri në këtë datë, nga subjekti nga maturimi i depozitës ekzistuese në “Raiffeisen Bank” sh. a., me interes 5.6%.

11.1.5 Vlera prej 1.178.400 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh e tërhequr nga depozita në “Raiffeisen Bank” për t'ia dhënë hua shtetasit P. B. ka si burim të ardhura të përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.1.2007, ndaj huamarrësit H. B. (të trajtuar në pikën 10 në vendim) dhe për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë ligjshmërinë e saj sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

11.1.6 Në përfundim rezulton se shumatat e dhëna hua janë tërhequr nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes dhe i janë dhënë hua *cash* shtetasit P. B. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave me të cilat janë krijuar depozitat apo llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i ka kaluar barra e provës së bashku me analizën financiare për vitet 2003 – 2016.

11.1.7 Lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale nga interesi i huas, subjekti ka shpjeguar se tatimin mbi të ardhurat personale nga interesat e huas e ka paguar së bashku me të ardhurat nga interesat e huas dhënë shtetasit A. D. nga bashkëshortja e tij, përkatësisht:

a) për vitin 2013 një shumë prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekësh (interesa nga shtetasi P. B.);

<sup>24</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, Aneksi \*\*\*.

b) për vitin 2014 një shumë prej 214.000 (dyqind e katërbëdhjetë mijë) lekësh [114.000 (njëqind e katërbëdhjetë mijë) lekë interesa nga shtetasi P. B. + 100.000 (njëqind mijë) lekë interesa nga shtetasi A. D.];

c) për vitin 2015 një shumë prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh [80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë interesa nga P. B. + 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë interesa nga shtetasi A. D.];

ç) për vitin 2016 një shumë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekësh [50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë interesa nga P. B.].

11.1.8 Bazuar në Kontratën e Huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2011, me afat shlyerje 2 vjet, konstatohet se huamarrësi nuk i është përmbajtur kushteve të pagesës sipas kontratës së nënshkruar midis palëve, si dhe transaksionet midis subjektit të rivlerësimit dhe huamarrësit janë kryer *cash*, jashtë sistemit bankar. Në këto kushte, deklarimi i arkëtimit të kësteve, interesave apo edhe kamatëvonesave ngelen në vetëdeklarimin e subjektit dhe dakordësisë së tij me huamarrësin. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision deklarata të firmosura midis palëve për pagesën e huas nga huamarrësi P. B..

11.1.9 DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, konfirmon për Komisionin faktin që subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar dhe paguar tatim mbi të ardhurat personale, por duke mos specifikuar të ardhurën, pasi nga subjekti nuk është ngarkuar asnjë dokument në sistem mbi burimin e të ardhurave (kontrata përkatëse e huadhënies).

11.1.10 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>25</sup>, shprehet se huamarrësin P. B. e ka njohur nëpërmjet një mikut të tij në vitin 2011 dhe huamarrësi e ka përdorur huan për ndërtimin e një banese në qytetin e Gramshit dhe të ardhurat e përdorura për pagesën e huas janë të ardhurat nga aktiviteti tregtar si kasap i regjistruar në QKB si Person Fizik në vitin 2003, me NIPT \*\*\*.

11.1.11 Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2017, të lëshuar nga Bashkia Gramsh për subjektin tregtar “P. B.” Person Fizik, rezulton se ky subjekt është biznes i vogël pa TVSH dhe për vitet 2012, 2013 dhe 2016 ka paguar vetëm taksat e bashkisë dhe nuk i është llogaritur tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, pasi ka deklarim xhiro nën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

11.1.12 Në përfundim, nga hetimi lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me datat kur janë tërhequr prej tij fondet nga llogaritë bankare apo kur janë bërë përsëri derdhjet e tyre në këto llogari nga subjekti i rivlerësimit. Ai ka deklaruar shumat e përfituara në deklaratimet DIVA të kryera prej tij duke paguar edhe tatimin përkatës, por pagesa e tatimit nuk është bërë sipas kontratave përkatëse, por verbalisht (sipas shpjegimeve të subjektit) dhe kontratat nuk janë respektuar. Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit janë kryer *cash*, jashtë sistemit bankar dhe kjo krijon paqartësi dhe mosbesueshmëri mbi të gjithë këtë veprimtari të kryer prej tij.

11.1.13 Qëndrimi i Komisionit lidhur me këtë huadhënie nga subjekti i rivlerësimit, duke i vlerësuar këto veprime si të kryera në mungesë të plotë të transparencës, e që ngenë dyshime mbi ekzistencën e fiktivitetit apo deklaratimit të rremë nga subjekti i rivlerësimit, është se ai ka cenuar figurën e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë me veprimet e mosveprimet e tij. Të para në tërësi veprimet e subjektit mbi këto huadhënie, të cilat fillojnë herët në vitet 2000 e vazhdojnë edhe më pas kësaj huadhënieje, duket se ka një zinxhir veprimesh që nuk justifikojnë burimin e ligjshëm dhe nuk përmbushin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Parë në këndvështrimin e veprimeve të kryera nga një gjyqtar që ka njohje dhe dijeni të plotë mbi kuadrin legjislativ shqiptar dhe detyrimet për pagimin e tatimeve mbi të ardhurat, veprimet e kryera prej tij jo vetëm që nuk krijojnë transparencë, por përkundrazi e shmangin atë dhe mbeten vetëm në kontekstin deklarativ.

11.1.14 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurisë monetare në vlerën 326.000 (treqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë (interes + kamata mbi shumën 2.100.000 lekë), si dhe ligjshmërinë e shumës së dhënë hua si principal, të situatës negative financiare, ndodhen më poshtë në këtë vendim, në kreun e analizës financiare për vitet 2003 – 2016.

**11.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* hua në shumën 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë, dhënë bashkëshortëve A. dhe Sh. D., me interes 10% në vit, me Kontratën e Huas**

<sup>25</sup> Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit datë 15.1.2021.

nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.5.2013, me palë huadhënëse bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, znj. T. A..

11.2.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të ardhurat nga depozita e mbyllur në të njëjtën ditë në bankën “Societe Generale Albania”, si dhe pagën e vitit 2013.

11.2.2 Sipas Kontratës së Huas<sup>26</sup> nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.5.2013, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huadhënëses, u ka dorëzuar huamarrësve A. dhe Sh. D. shumën prej 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekësh në zyrën e noterisë dhe afati i dhënies së huas është për një afat të pacaktuar.

11.2.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>27</sup>, shprehet se huamarrësin A. D. e njeh që prej vitit 2004, i cili është punonjës në Bashkinë Gramsh dhe huaja është përdorur për të paguar çmimin e truallit për legalizimin e banesës në Gramsh. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision deklarata të firmosura midis palëve për pagesën e huas nga huamarrësi, si dhe ka përcjellë dokumentacion për të provuar aftësinë paguese të huamarrësit A. D..

11.2.4 Lidhur me këtë hua, subjekti ka deklaruar se ka përfituar interesa në shumën 170.000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat 100.000 (njëqind mijë) lekë në vitin 2014 dhe 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në vitin 2015. Subjekti ka deklaruar se tatimi mbi të ardhurat nga interesat e kësaj huaje është paguar së bashku me tatimin mbi huan e shtetasit P. B. dhe qiranë e vëllait A. A..

11.2.5 DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, konfirmon për Komisionin faktin që subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar dhe paguar tatim mbi të ardhurat personale, por duke mos specifikuar të ardhurën, pasi nga subjekti nuk është ngarkuar asnjë dokument në sistem mbi burimin e të ardhurave.

11.2.6 Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë, duket se si burim për dhënie huaje shtetasit A. D., ka shërbyer tërheqja e depozitës në vlerën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë në “OTP Bank”, në datën 29.5.2013.

11.2.7 Në bazë të kontratës së huas, huadhënësi është bashkëshortja e subjektit, znj. T. A., e cila është edhe përfituesja e interesave nga kjo hua dhe në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duhet të kryente pagesën e këtij tatimi lidhur me këtë hua.

11.2.8 Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se shumat janë dhënë hua nëpërmjet veprimeve *cash* jashtë sistemit bankar, megjithëse shumat kanë qenë të depozituara në bankë, po ashtu shumat e deklaruara të kthyera së bashku me interesat e kësteve të huas veçanërisht e principalit për vitet 2014-2015 nuk mund të provohen dhe, për këtë arsye, nuk janë konsideruar në analizën financiare të viteve 2003 – 2016, dërguar subjektit të rivlerësimit së bashku me barrën e provës.

11.2.9 Nisur nga dyshime të Komisionit lidhur me ekzistencën e këtyre marrëdhënieve dhe konfuzionin e krijuar nga subjekti i rivlerësimit në tërësi lidhur me to, e mungesës së transparencës, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit edhe informacion lidhur me huadhënësit, objektin e veprimtarisë dhe mundësitë e tyre financiare. Në disa raste ata dalin si persona të afërt apo miq me subjektin, por ndërkohë mbetet i dyshimtë interesi i lartë 10% dhe kamatat e kërkuara në raste vonesash. Në disa raste të tjera huadhënësit janë njerëz të panjohur, për të cilët subjekti shprehet me konsiderata negative dhe se ata nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës, e çështjet janë zgjidhur në rrugë gjyqësore (shihni një rast trajtuar më lart në vendim, hua në vitin 2000 dhe një rast trajtuar më poshtë në vendim, hua në vitin 2004, të dyja të fituara në rrugë gjyqësore, me një interes sa dyfishi i shumës së dhënë hua).

11.2.10 Në përfundim, nga hetimi rezultoi se datat e deklarimeve nga subjekti përputhen me datat e tërheqjeve të shumave përkatëse në llogaritë bankare. Subjekti krijon konfuzion dhe paqartësi lidhur me kthimin mbrapsht të shumave dhe pagimin e detyrimeve tatimore, situatë që mbeti e tillë deri në fund.

11.2.11 Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se është përgjegjësi dhe detyrim i subjektit të rivlerësimit të bëjë transparencë dhe të kryejë veprimet juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi e të provojë mbi ligjshmërinë e tyre, e se subjekti rivlerësimit ka ngritur vetëm një skemë me bazë deklarative, konfuzo dhe aspak transparente për të cilën trupi gjykues krijoi bindjen se janë deklarime të reme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

<sup>26</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, Aneksi \*\*\*.

<sup>27</sup> Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit datë 15.1.2021.

11.2.12 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për dhënien e huas, si dhe situata negative financiare dhe qëndrimi i Komisionit ndodhen më poshtë në vendim, në analizën financiare për vitet 2003 – 2016.

**11.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* hua në shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë shtetasit F. M., me interes sa interesi maksimal i depozitave me afat 1-vjeçar në “Raiffeisen Bank” ose Bankën Popullore plus 1%, me aktmarrëveshje me shkresë të thjeshtë, në datën 10.5.2015, me afat 2-vjeçar.**

11.3.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi për dhënien e kësaj huaje të ardhurat nga paga si bashkëshortë dhe kursimet e mëparshme.

11.3.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>28</sup> lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga interesi i huas në shumën 24.000 (njëzet e katër mijë) lekë, deklaroi se në datën 8.2.2018 ka paguar tatimin përkatës së bashku me tatimin mbi të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Gramsh nga vëllai A. A..

11.3.3 DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, konfirmon për Komisionin faktin që subjekti i rivlerësimit në datën 8.2.2018 ka vetëdeklaruar dhe paguar tatim mbi të ardhurat personale për vitin 2017, në vlerën 21.600 (njëzet e një mijë e gjashtëqind) lekë, përkatësisht për të ardhura nga qiraja në shumën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë dhe të ardhura të tjera në shumën 24.000 (njëzet e katër mijë) lekë, por duke mos e specifikuar këtë të fundit, pasi nuk ka dokument të ngarkuar në sistem.

11.3.4 Referuar aktmarrëveshjes datë 10.5.2015, interesi i huas ishte përcaktuar 1-vjeçar dhe duhej paguar me plotësimin e këtij afati, kurse sipas shpjegimeve të subjektit interesi është paguar i gjithi në përfundim të afatit 2-vjeçar të huas.

11.3.5 Kjo huadhënie nuk është kanalizuar nëpërmjet llogarive bankare, por është realizuar nëpërmjet veprimeve *cash* dhe, gjithashtu, arkëtimi i kësteve është realizuar nëpërmjet veprimeve *cash* dhe jo nëpërmjet llogarive bankare, pavarësisht faktit që shtetasi F. M. ka mbajtur llogari aktive në “Raiffeisen Bank” sh. a.,<sup>29</sup> gjatë vitit 2017, periudhë kur është deklaruar shlyerja e plotë e huas nga subjekti.

11.3.6 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>30</sup>, shprehet se huamarrësin F. M. e njeh prej vitit 1990, i cili ka qenë veteriner dhe i punësuar ndër vite në institucionet shtetërore. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se debitori i ka përdorur fondet për nevoja familjare dhe burimin e pagesës së huas e ka nga përfitimi i të ardhurave në vlerën 1.324.500 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të datës 16.12.2014, të Gjykatës Administrative Durrës, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor privat H. C.<sup>31</sup>. Sipas shkresës së përmbaruesit, shuma prej 1.324.500 lekësh si dëmshpërblim page është transferuar në llogarinë bankare të kreditorit F. M. në datën 4.5.2017 në “Raiffeisen Bank”.

11.3.7 Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për t’i dhënë hua shtetasit F. M. në datën 10.5.2015.

11.3.8 Nisur nga dyshime të Komisionit lidhur me ekzistencën e këtyre marrëdhënieve, konfuzionin e krijuar nga subjekti i rivlerësimit në tërësi lidhur me to dhe mungesën së transparencës, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit edhe informacion lidhur me huadhënësit, si dhe për mundësitë e tyre financiare. Në këtë rast huamarrësi është një person i afërt e mik me subjektin, por ndërkohë mbetet i dyshimtë interesi i lartë 10%. Po ashtu, shlyerja e huas nuk është përmbushur sipas deklaratës (së thjeshtë), por në një kohë të mëvonshme e cila del përtej periudhës *Vetting* dhe, për pasojë, nuk është përfshirë përfitimi i këtyre të ardhurave në analizën financiare për vitet 2003 – 2016 dhe është analizuar vetëm veprimi lidhur me huadhënien nga ana e subjektit.

11.3.9 Dhënia e kësaj huaje mbetet deklarative, me një akt të thjeshtë të kryer jo në rrugë bankare dhe ngre dyshime mbi ekzistencën e saj e për të cilën trupi gjyqësor krijoi bindjen se janë deklarime të reme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

<sup>28</sup>Shihni përgjigjen nr. 11, të pyetësorit datë 15.1.2021.

<sup>29</sup>Depozituar mandat tërheqje nga llogaria e shtetasit F. M. në “Raiffeisen Bank” në datën 18.5.2017.

<sup>30</sup>Shihni përgjigjen nr. 2, të pyetësorit datë 15.1.2021.

<sup>31</sup>Vërtetim datë 22.1.2021, nga përmbaruesi gjyqësor H. D. C..

11.3.10 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për dhënien e huas, si dhe situata negative financiare, shpjegimet ndodhen më poshtë në vendim, në kreun e analizës financiare për vitet 2003 – 2016.

## GJETJE TË TJERA

**12. Hua në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, dhënë shtetasit D. X., më 22.7.2004<sup>32</sup>, me afat kthimi 1 vit dhe interes 10%, e pa deklaruar nga subjekti i rivlerësimit**

12.1 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit, deklaroi se kjo hua është dhënë nga të ardhurat e vëllezërve të tij B. dhe K. A., emigrantë në Angli, të cilët kanë dërguar në emër të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet institucioneve financiare (Western Union dhe MoneyGram), të ardhura që mbaheshin në banesën e subjektit për arsye sigurie. Subjekti deklaroi<sup>33</sup>: *“Dy vëllezërit e mi, të quajtur K. A. e B. (N. A.), me sa me kujtohet në vitin 2000 kanë emigruar ilegalisht në Angli. K. A. është rezident prej asaj kohe në Angli, ku ka krijuar familje e jeton bashkë me bashkëshorten e dy djemtë. Ndërsa vëllai tjetër B. A. u kthye me sa më kujtohet në nëntor të vitit 2004. Në vitet 2001 – 2004, nga asistenca dhe puna në shtetin anglez ata kanë sjellë në Shqipëri një sasi të ardhurash. Këto të ardhura kanë ardhur nëpërmjet institucioneve financiare (Western Union dhe MoneyGram). Një pjesë kanë ardhur nën emrin e tyre. Një pjesë tjetër nën emrin e disa personave të tjerë, që ishin shokë të tyre. Dërgesat kanë ardhur në emrin tim dhe në emrin e tim vëllai P. A., që në vitin 2001 ishte student në Tiranë”.*

12.2 Nga subjekti i rivlerësimit është depozituar deklarata e thjeshtë nga shtetasi B. Ç. në datën 22.7.2003, sipas së cilës ai deklaroi se i ka marrë shtetasit P. A. hua shumën 20.000 USD, me afat 1-vjeçar, me interes 20.000 (njëzet mijë) lekë/muaj. Kjo shumë, me të njëjtat kushte, iu dha shtetasit D. X..

12.3 Në datën 22.7.2004, subjekti i rivlerësimit, së bashku me shtetasin D. X. kanë nënshkruar një deklaratë dore, sipas së cilës subjekti i ka dhënë hua shtetasit D. X. shumën 2.500.000 lekë, me afat kthimi 1 vit dhe interes 10%. Në këtë deklaratë thuhet se shuma është e vëllezërve B. dhe K. A..

12.4 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për shkak të moskthimit të shumës së dhënë hua, ai ka ngritur padi ndaj shtetasit D. X. pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i huas.

12.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2016, ka vendosur detyrimin e të paditurit D. X. t'i kthejë paditësit Ramazan Avdiu shumën e marrë hua prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, si dhe dënimin e shkaktuar nga vonesat në vlerën e kamatëvonesave sipas interesit më të lartë bankar, aplikuar nga bankat e nivelit të dytë në datën 22.7.2005. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar në datën 28.6.2016.

12.6 Gjykimi pranë kësaj gjykate është zhvilluar në mungesë të palës së paditur dhe njoftimi i saj është kryer me shpallje.

12.7 Nga hetimi ka rezultuar se shumata e mësipërme janë disponuar nga subjekti i rivlerësimit, duke u dhënë më tej si hua me interes, si dhe duke kërkuar në rrugë gjyqësore kthimin e tyre. Këto marrëdhënie nuk janë deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*.

12.8 Lidhur me burimin e shumave të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kopje të transfertave nëpërmjet “MoneyGram” dhe “Western Union” nga Anglia në emër të tij dhe të vëllait P. A.. Referuar transfertave rezultoi se disa prej tyre janë dërguar nga 2 vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, por një pjesë e mirë e tyre (më së shumti) janë dërguar nga persona të tjerë, si: J. Sh., Sh. S., A. K., E. J., Xh. N., S. K., K. Ç. dhe J. H..

12.9 Në vlerësim të fakteve dhe dokumenteve të mbledhura gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka dashur të fshehtë veprimet e kryera më sipër, duke i përjashtuar ato nga hetimi dhe verifikimi që kryen ILDKPKI-ja, por edhe Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bërë kështu deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë në pronësi, posedim apo përdorim të tij ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*.

<sup>32</sup>Shihni përgjigjen nr. 7, në pyetësorin e datës 8.1.2020.

<sup>33</sup>Shihni përgjigjen nr. 7, në pyetësorin e datës 8.1.2020.

12.10 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

12.11 Në vijim, subjekti ka shpjeguar: *“Unë nuk e kam deklaruar në DIPV-në e vitit 2003, pasi shuma prej 20.000 USD nuk ishte pronë e imja. Unë ato të holla i kam mbajtur vetëm në ruajtje dhe kur i janë dashur anëtarëve të familjes së tim eti u jepja shumat që kërkoheshin. I mbaja unë në ruajtje, pasi kushtet e sigurisë në shtëpinë e prindërve linin për të dëshiruar, ndërsa unë në atë kohë kisha vënë të paktën një derë hekuri të jashtme. Vëllezërit kanë punuar në informalitet dhe për këtë shkak nuk mund të vërtetohet mënyra e fitimit të këtyre parave. Por theksoj se jo vetëm ata, por asnjë nga të afërmit e mi që unë njoh, nuk është dënuar ndonjëherë, brenda apo jashtë shtetit, qoftë edhe për një kundërvajtje penale”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

12.12 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se shumat e dërguara në emër të subjektit të rivlerësimit janë disponuar prej tij duke dhënë hua me interes, si dhe duke kërkuar në rrugë gjyqësore kthimin e tyre. Të gjitha veprimet për realizimin e kësaj marrëdhënieje huaje janë realizuar prej tij dhe se ai nuk është kujdesur të dokumentojë në ndonjë formë ligjore dhe si njohës i legjislacionit në fuqi e si përfaqësues i sistemit të drejtësisë nuk mund të mendohet se nuk kishte dijeni apo se mund të kryente veprime të tilla në emër të vëllezërve, megjithëse ligjshmëria e burimeve ishte e paditur dhe se marrëdhënia konkrete ishte tërësisht informale dhe jokohërente me detyrën e tij.

12.13 Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa konkretë për kërkimin e këtyre shumave duke ngritur personalisht padi në gjykatë, gjë që në vlerësim të trupit gjykues është një veprim jashtë çdo etike gjyqësore dhe në një vlerësim të përgjithshëm, në cenim të plotë të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Edhe sikur kjo huadhënie të besohet se është me burim të ardhurash nga vëllezërit nga punësimi në emigracion, subjekti i rivlerësimit nuk duhet të kishte ndërmarrë veprime për kryerjen e një marrëdhënieje të tillë, tërësisht informale dhe me burime të panjohura dhënë shtetasve të panjohur gjithashtu. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka fshehur këtë pasuri nga deklarata *Vetting* si dhe kontrolli i ILDKPKI-s ndër vite dhe se veprimet e tij janë të gabuara dhe cenojnë rëndë etikën dhe figurën e gjyqtarit.

12.14 Në përfundim rezulton se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim, ose përdorim të tij dhe se në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit, pasi nuk mund të provojë dot të kundërtën.

**13. Depozitë bankare në vlerën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, çelur në emër të bashkëshortes T. A. në “OTP Bank” sh.a., në datën 1.10.2010, e padeklaruar si çelje depozite.**

13.1 Kjo depozitë rezulton e krijuar nga vlera: (a) 437.240 (katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet) lekë e tërhequr në datën 1.9.2010, nga subjekti Ramazan Avdiu nga llogaria e tij në “OTP Bank”; dhe (b) 500.000 (pesëqind mijë) lekë e tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”; (c) plus diferenca në shumën 562.760 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë nga të ardhurat *neto* nga pagat e bashkëshortes deri në datën e krijimit të depozitës.

13.2 Nga hetimi i veprimeve bankare lidhur me krijimin e kësaj depozite rezultoi se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për të krijuar likuiditetet/depozitat në datën 28.4.2005, në shumat 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 3.000 (tre mijë) USD. Kjo pamundësi vinte si rezultat i pasqyrimit të gjendjes *cash* në vitin 2003 nga vlera 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në vlerën 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, e cila sjell gjendjen *cash* në fund të vitit 2004, në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë.

13.3 Pas reflektimit të kësaj situatë, subjekti i rivlerësimit rezulton me burime të ligjshme për krijimin e depozitës në datën 28.4.2005, por nuk e ka deklaruar në DIPV-në përkatëse.

**14. Shumë *cash*, deklaruar si kursime në fund të vitit 2007, krijuar nga mbyllja e depozitës në “OTP Bank” dhe mbajtur *cash* në banesë [tërhequr shuma, kryer këmbimi sipas kursit dhe shuma prej 885.000 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekësh mbajtur gjendje *cash* në banesë].**



14.1 Nga hetimi i llogarisë bankare të subjektit në “OTP Bank” sh. a., rezulton se në datën 4.5.2007, depozita në vlerën 3.641 (tre mijë e gjashtëqind e dyzet e një) USD është maturuar dhe transferuar në llogarinë e vëllait të tij B. A. në po atë datë.

14.2 Në DIPV-në e vitit 2007 subjekti deklaron: *“Pakësuar depozita bankare në emrin tim në vlerën 3.641 USD në Bankën Popullore dega Gramsh. Mbyllur kjo depozitë në datën 4.5.2007, shuma e dollarëve u konvertua në datën e mësipërme me kurs 1 USD = 91.99 lekë.*

*Shtuar shuma e parave cash në banesë në vlerën 885.000 lekë (shuma prej 335.000 lekësh vjen si pasojë e konvertimit të shumës 3.641 USD në maj të vitit 2007 nga mbyllja e depozitës përkatëse)”*.

14.3 Në analizën financiare të Komisionit, shuma 3.641 (tre mijë e gjashtëqind e dyzet e një) USD nuk është marrë në konsideratë duke qenë se fondet e kësaj depozite rezultuan të transferuara në datën 4.5.2007, në llogarinë e vëllait të tij (ndryshe nga sa deklaron vetë subjekti në DIPV).

14.4 Për këtë, subjektit i kaloi barra e provës për të shpjeguar lidhur me mospërputhjet mbi deklaratimet e tij, si dhe me burimin e ligjshëm për krijimin e gjendjes *cash* në vitin 2007.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

14.5 Në vijim të rezultateve, subjekti shpjegon:

- a) *“Në datën 4.5.2007 unë e kam mbyllur këtë depozitë, duke ia kaluar shumën në llogari vëllait tim B. A. me kërkesën e vëllait A. A., të cilët në atë kohë kishin ekonomi familjare të përbashkët.*
- b) *Në vitin 2007, vëllai im A. A., pasi kishte mbaruar studimet universitare në Tiranë në vitin 2006, ka dashur të vijoje studime universitare në Angli.*
- c) *Pasi ka kontaktuar me një universitet që kishte zgjedhur dhe kishte marrë konfirmimin paraprak që mund të aplikonte për vitin akademik 2007 - 2008, në prill më ka kërkuar që të transferoja shumën që disponoja në dollarë në “OTP Bank” në llogarinë e vëllait B. A., me të cilin kishte rënë dakord që llogaria e tij të bëhej me 2 emra.*
- ç) *Këtë veprim e ka bërë pasi në rast se pranohej aplikimi në universitet, duhet të merrte vizë pranë Ambasadës Britanike në Tiranë dhe marrja e vizës kërkonte që të kishte garanci financiare në bankë në emrin e tij. Më pas, A. ka hequr dorë nga aplikimi dhe kundërvlera e shumës 3.641 USD më është kthyer në lekë cash nga vëllai im B. A. brenda vitit 2007.*
- d) *Bashkëngjitur po paraqes një deklaratë nga vëllai im A. A. ku dëshmon rreth rrethanave të kryerjes së këtij kalimi dhe kthimi. Theksoj se transferimi dhe kthimi janë kryer brenda vitit 2007 dhe duke qenë se në DIPV-në e vitit 2007 kërkohej të deklaroheshin vetëm shtesat e zvogëlimet në fund të vitit, unë nuk kam pasqyruar veprime që kanë pasur efekt me vlerë 0 (zero), pra, dhënie apo marrje huaje pa interes apo transferim e kthim brenda vitit”*.

14.5.1 Subjekti ka paraqitur ekstrakt të llogarisë së vëllait të tij për periudhën 9.3.2006 -13.8.2007, nga “OTP Bank”.

14.5.2 Për sa më sipër, subjekti shprehet: *“Kërkoj që shuma prej 3.641 USD të përfshihet në të ardhurat e mia të ligjshme pasi është krijuar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka pasur asnjë përpjekje nga ana ime për fshehjen e kësaj shume. Kërkoj që efektet në analizë nga kjo shumë të reflektohen saktësisht në të gjithë analizën që pason”*.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

14.6 Në vlerësim të dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekti e fakteve të rezultuara gjatë hetimit rezulton se deklaratimet e subjektit në DIPV-në e vitit 2007 bien ndesh me rezultatet/gjetjet e Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Prova e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me transfertën e kryer prej tij të vëllait nëpërmjet transfertës bankare tregon vetëm veprimin e kryer për transferimin e shumës dhe nuk pasqyron fakte të mëvonshme mbi këtë shumë. Në llogarinë e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë veprime të mëpasshme apo transferta nga vëllai i tij për kthimin e shumës. Kjo provë e paraqitur prej tij nuk sjell ndonjë ndryshim nga ai i rezultatit të hetimit se shuma e pretenduar nuk ishte tërhequr dhe konvertuar duke u mbajtur *cash* në banesë, por ishte transferuar te llogaria e vëllait të subjektit. Shpjegimet e dhëna prej subjektit nuk provojnë pse ka kryer deklaratime të ndryshme në DIPV dhe as provojnë se ajo shumë është

kthyer prej vëllait të tij brenda vitit, dhe është përdorur nga subjekti për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit dhe as pretendimet e tij. Trupi gjykues i Komisionit nuk e ka marrë në konsideratë në analizën financiare të vitit 2007 këtë shumë si burim për krijimin e gjendjes *cash*, duke e konsideruar deklarin e subjektit të rremë.

**15. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është bashkëpronare e apartamentit me sip. 55.5 m<sup>2</sup>, në Gramsh, fituar bashkërisht me familjen e saj me Kontratën e datës 9.2.1994 nga NK Banesave Gramsh në shumën 5.256 (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë. Fillimisht bashkëshortja ka qenë pronare mbi ¼ pjesë.**

15.1 Zyra Vendore Gramsh e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës konfirmon këtë pasuri, të llojit “apartament” me sip. 55.5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, , p. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati përdhes, ap. nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*”, Gramsh, me bashkëpronarë shtetasit Sh. L., A. D. dhe T. D., përfituar me akt trashëgimie.

## **16. Analizë financiare për periudhën 2003 – 2016**

Komisioni, për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, në këtë analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, përgjigjet e pyetësorëve të datave 8.1.2020, 22.12.2020, 24.12.2020, 24.1.2021 dhe 25.1.2021. Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2020, nga “Raiffeisen Bank” (dosja e Komisionit). Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2021, nga “OTP Bank” (dosja e Komisionit), si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jobublike.

16.1 Rezultati i analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, është me vlerë negative -5.002.869 (pesë milionë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Në këtë analizë janë reflektuar problematikat lidhur me huadhëniet dhe të ardhurat e përfituara të shpjeguara më lart, si dhe nuk janë marrë në konsideratë pjesërisht vlerat e arkëtuara nga shtetasit P. B. dhe A. D. Nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga vendimi gjyqësor në vitin 2009 si nga interesat ashtu edhe lidhur me shumën e dhënë hua (principalin), duke mos marrë në konsideratë vlerën 2.473.000 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë. Janë marrë në konsideratë interesat bankare të realizuara nga këto të ardhura nëpërmjet sistemit bankar.

16.2 Rezultati financiar i analizës deri në vitin 2003 është paraqitur sipas problematikave lidhur me pasuritë përkatëse duke pasqyruar rezultat negativ në vitin 1996 për blerjen e pasurisë apartament, si dhe rezultat negativ në vitin 2002 për dhënien e huas shtetasit H. B.. Në total, rezultati negativ për periudhën deri në fillim të vitit 2003 është në vlerën kumulative prej -700.259 (shtatëqind mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh.

16.3 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit dhe për të justifikuar balancat negative lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet në këndvështrimin e përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

16.4 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar lidhur me huadhëniet e tij shtetasve P. B., A. D. dhe F. M., duke kërkuar përfshirjen e shumave të kthyer nga huat në analizën financiare të viteve 2003 – 2016, si dhe pranimin e të ardhurave nga vendimi gjyqësor në vitin 2009 (ekzekutimi i huas nga shtetasi H. B.), duke paraqitur dokumentin mbi pagimin e tatimit për të ardhurat në vitin 2021. Në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merret në konsideratë edhe vlera 3.641 (tre mijë e gjashtëqind e dyzet e një) USD në vitin 2007, të rishikohen shpenzimet jetike të kryera prej tij dhe problematika e konstatuar lidhur me pasqyrimin e gjendjes *cash* në vitin 2003, si dhe rishikimi i shpenzimeve për ndërtimin informal të kryer në vitin 2012 dhe vlera e blerjes së pasurisë apartament prej 3.000.000 (tre milionë) lekësh në vitin 2010.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

16.5 Pas rishikimit të analizës financiare për periudhën 1989 – prill 2002 lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në vlerën - 546.380 (pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë për blerjen e pasurisë apartament në nëntor të vitit 1996 dhe dhënien e huas në prill të vitit 2002. Në këtë analizë financiare nuk është marrë në konsideratë vlera e kredisë në vitin 1994, pagesat për shlyerjen e saj deri në vitin 1998, si dhe të ardhurat nga shitja e minitraktorit

në vitin 1996, për të cilat nuk provohet me dokumentacion ligjor ekzistenca e tyre. Komisioni ka pranuar dhe rishikuar shpenzimet jetike, të cilat janë arsyetuar më lart në vendim.

16.6 Pas rishikimit të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, ka rezultuar se nga reflektimi i ndryshimit të gjendjes *cash* në vitin 2003, në vlerën 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, ndryshon rezultati pozitiv i këtij viti nga vlera 168.254 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë në rezultat negativ me vlerën -146.746 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekë. Komisioni ka rishikuar analizën financiare, duke vlerësuar të mos pranojë si të ardhura shumat e kthyer nga huadhënësit P. B. dhe A. D., pasi mbeten vetëm në kontekstin deklarativ dhe të paprovuara për Komisionin me ndonjë dokument financiar apo ligjor provues. Është rishikuar analiza financiare lidhur me shpenzimet e kryera nga subjekti për pasuritë e tij, të trajtuara më lart në vendim. Nuk janë përfshirë të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në vitin 2009 për huan e dhënë shtetasit H. B.. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezulton me një situatë negative në vlerën -4.798.862 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë (për më shumë shihni tabelën bashkëlidhur në fund të vendimit).

17. Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka blerë në korrik të vitit 2017 **pasurinë apartament me sip. 70.63 m<sup>2</sup>, në vlerën 48.000 (dyzet e tetë mijë) euro**, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me burim krijimi të ardhura nga llogaria rrjedhëse, kursimet *cash* dhe depozita. Kjo pasuri nuk është përfshirë në rivlerësimin e subjektit Ramazan Avdiu, pasi është krijuar pas periudhës *Vetting*. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se çdo hetim apo konkluzion lidhur me të apo burim i të ardhurave të përdorura nuk do të ndikonte në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

18. Gjatë hetimit administrativ dhe gjetjeve të rezultuara mbi huadhëniet me interes të kryera nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, në shuma të konsiderueshme, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë nëse janë ato marrëdhënie në harmoni me dispozitat kushtetuese dhe kuadrin ligjor, si dhe nëse bien ndesh ato veprime me figurën e gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

18.1 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar sa vijon:

*“Huat kanë qenë sporadike; në dy nga rastet u janë dhënë personave në rrethin tim të ngushtë shoqëror e miqësor; në një rast një të njohuri të një mikut tim; nuk kam nxitur kryerjen e veprimeve të paligjshme prej huamarrësve; interesat e huave kanë qenë në masën e interesave bankare, afërsisht sa interesi që do ta përfitoja edhe nga depozitimi në një bankë ose më i ulët se interesi i kredive bankare.*

*Vlerësoj se me këto veprime nuk kam kryer akte e sjellje që kanë cenuar rëndë figurën time dhe besimin e publikut në drejtësi, pasi nuk kam kryer veprime të paligjshme, të parregullta apo amorale, nuk kam abuzuar me besimin e publikut, nuk e kam dhunuar atë, nuk kam dëmtuar as interesat e shtetit dhe shoqërisë. Unë u kam dhënë këtyre shtetasve kursimet e mia”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

18.2 Në vlerësim të trupit gjykues huadhëniet kanë qenë jo vetëm të përsëritura, por duket si një taktikë punë e gjyqtarit e kryer gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës. Pretendimet e tij se huat kanë qenë sporadike dhe shumat modeste po ashtu, nuk qëndron, pasi shumat e dhëna hua janë ato maksimale të përfituara nga të ardhurat e subjektit dhe se ai nuk ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shuma më të larta. Në një rast në vitin 2004, subjekti ka dhënë një hua përtej mundësive të tij dhe pa asnjë përpjekje për të legjitimuar burimin e kësaj huaje për të cilën ai po ndërmernte veprime konkrete dhe që duhej të ishte kujdesur si gjyqtar i Republikës së Shqipërisë t'i bënte me transparencë të plotë.

18.3 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka nxitur veprime të paligjshme të huamarrësve, por në të paktën një rast kur ka vepruar si huadhënës ndaj shtetasit D.X., ka dhënë hua në shuma të konsiderueshme dhe përkundrajt një interesi të palogjikshëm tregtar për kohën [20.000 (njëzet mijë) lekë/muaj] e duket se huamarrësi mund të ketë pasur edhe qëllime paligjshme.

18.4 Pretendimet se interesat e huave kanë qenë në masën e interesave bankare, afërsisht sa interesi që do ta përfitonte edhe nga depozitimi në një bankë, ose më i ulët se interesi i kredive bankare është i pambështetur në ndonjë provë apo fakt, pasi nga hetimi ka rezultuar se interesat e tij kanë qenë të larta dhe përtej atij bankar dhe se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë për këtë pretendim. Logjika e përdorur nga subjekti i rivlerësimit nuk mundi të bindë Komisionin, pasi nëse ai do të kishte dashur të përfitonte interesin bankar mund t'i linte lekët në depozitë (pasi ashtu i kishte ato fonde) e të përfitonte interesa në rrugë transparente.

18.5 Veprimtaria e huadhënieve nga ana e subjektit e vlerësuar në tërësi duket e dyshimtë dhe krijon perceptimin e veprimeve të kryera si një skemë për justifikimin e të ardhurave, e cila realizohet tërësisht në informalitet dhe pa asnjë përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të krijuar transparencë. Duket sikur subjekti rivlerësimit, krahas ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar i Republikës së Shqipërisë ka ushtruar edhe veprimtari që duhet të ushtrohet nga banka apo persona të licencuar, që në të paktën dy raste ka rezultuar se u ka shkaktuar pasoja të rënda huamarrësve deri në sekuestrim të pasurive të tyre nëpërmjet ekzekutimeve gjyqësore.

18.6 Ushtrimi i kësaj veprimtarie nga një gjyqtar duket i papranueshëm me etikën e tij dhe në vlerësim të trupit gjykues është në cenim të besimit të publikut te drejtësia.

26. Në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë pas vlerësimit të rezultateve të hetimit në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të barrës së provës, si dhe vlerësimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë hetimit dhe akteve të administruara në vijim të barrës së provës dhe dëgjimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit për një pjesë të madhe të tyre.

26. Shumica e trupit gjykues i vlerëson këto konkluzione si të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

27. Në këto kushte, shumica e trupit gjykues çmoi të panevojshëm hapjen e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

28. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshme të pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

29. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe veprimeve të kryera prej tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 6.5.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare (Kundër)**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*

Ne detyre 31.03.1995																
Ramazan Avdiu																
Gjyqtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan																
Monedha Lekë ( ALL)													Rezultat Negativ - 4,798,862			
	89-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL 2003-2016
<b>PASURI</b>	<b>1,860,000</b>	<b>664,937</b>	<b>595,063</b>	<b>793,283</b>	<b>649,410</b>	<b>324,178</b>	<b>727,790</b>	<b>3,003,803</b>	<b>-476,643</b>	<b>830,975</b>	<b>1,561,786</b>	<b>1,440,568</b>	<b>1,500,246</b>	<b>1,549,952</b>	<b>650,257</b>	<b>13,815,605</b>
Pasuri e Trashëguar: Toke Are 1095m2																-
Pasuri e Trashëguar: Bashkepronar me 1/16 e Truall me sip. 300m2 /Ndertese 70m2																-
Pasuri e Trashëguar nga B/shortja llojit apartament 55 m2																-
Apartament 52.8m2	420,000															-
Ndertim Informal 68 m2											1,051,757					1,051,757
Toke Are me sip.2000 m2								400,000								400,000
Apartament sip.88.77 m2									3,000,000							3,000,000
Makine Volkswagen											501,660					501,660
<b>Debitor H.B:</b> Huadhenie 1,440,000 leke	1,440,000							-								-
<b>Debitor P.B:</b> Huadhenie 2,100,000								-		2,100,000						2,100,000
<b>Debitor A.D:</b> Huadhenie 1,400,000 leke												1,400,000				1,400,000
<b>Debitor F.M:</b> Huadhenie 600,000 leke														600,000		600,000
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	-	664,937	595,063	793,283	649,410	324,178	727,790	2,603,803	-3,476,643	-1,269,025	8,369	40,568	1,500,246	949,952	650,257	4,762,188
Likuiditete Gjendje	-	664,937	1,260,000	2,053,283	2,702,693	3,026,871	3,754,661	6,358,464	2,881,820	1,612,796	1,621,165	1,661,733	3,161,979	4,111,931	4,762,188	
<b>DETYRIME</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>200,000</b>	<b>-200,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Hua									200,000	-200,000						-
<b>PASURI NETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>1,860,000</b>	<b>664,937</b>	<b>595,063</b>	<b>793,283</b>	<b>649,410</b>	<b>324,178</b>	<b>727,790</b>	<b>3,003,803</b>	<b>(676,643)</b>	<b>1,030,975</b>	<b>1,561,786</b>	<b>1,440,568</b>	<b>1,500,246</b>	<b>1,549,952</b>	<b>650,257</b>	<b>13,815,605</b>
	89-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL 2003-2016
<b>TE ARDHURA</b>	<b>3,963,838</b>	<b>894,047</b>	<b>1,161,709</b>	<b>1,369,812</b>	<b>1,235,113</b>	<b>1,417,236</b>	<b>1,256,938</b>	<b>1,602,280</b>	<b>1,784,206</b>	<b>1,783,042</b>	<b>1,812,975</b>	<b>1,865,444</b>	<b>2,264,161</b>	<b>2,195,283</b>	<b>2,223,362</b>	<b>22,865,607</b>
Te ardhura nga paga e subjektit para fillimit te detyres	226,536															-
Te ardhura nga paga e subjektit pas fillimit te detyres 03/1995	3,078,751	713,877	949,409	1,035,457	985,169	1,052,204	839,871	983,294	1,052,247	1,040,733	1,091,057	1,082,808	1,327,860	1,343,580	1,410,460	14,908,026
Te ardhura nga paga e B/shortes	658,551	180,170	212,300	226,927	214,542	302,782	351,310	546,160	446,229	476,767	501,918	522,806	561,212	559,185	609,018	5,711,326
Te ardhura neto nga interesat bankar				107,428	35,402	62,250	65,757	72,826	285,730	145,542	0	79,830	41,089	22,518	33,884	952,255
Te ardhura nga interesat e Huadhenieve								0				60,000	214,000	150,000	50,000	474,000
Te ardhura qeraje										120,000	120,000	120,000	120,000	120,000	120,000	720,000
Te ardhura nga shitja e Automjetit te motres											100,000					100,000
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,344,760</b>	<b>375,856</b>	<b>375,856</b>	<b>438,228</b>	<b>438,228</b>	<b>848,792</b>	<b>612,546</b>	<b>828,301</b>	<b>1,261,480</b>	<b>586,480</b>	<b>770,077</b>	<b>845,511</b>	<b>1,313,664</b>	<b>1,494,952</b>	<b>1,298,460</b>	<b>11,488,432</b>
Shpenzime jetese	2,209,760	375,856	375,856	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	493,584	659,994	448,552	705,276	7,226,166
Shpenzime udhetimi TIMS											82,392	0	18,113	0	22,150	122,655
Shpenzime - tatimi fitimi mbi interesat e huave /qerave												18,000	33,400	40,500	91,900	
Shpenzime zhdoganimi								281,821								281,821
Shpenzime shkollimi												351,927	447,091	737,700	530,534	2,067,252
Shpenzime te ndryshme	135,000					302,312	66,066		715,000	40,000	129,493		170,466	275,300		1,698,637
<b>Analiza e Rezultatit ( Te ardhura- Shpenzime-Pasuri Neto)</b>	<b>(240,922)</b>	<b>-146,746</b>	<b>190,790</b>	<b>138,301</b>	<b>147,476</b>	<b>244,267</b>	<b>-83,398</b>	<b>-2,229,824</b>	<b>1,199,369</b>	<b>165,586</b>	<b>-518,888</b>	<b>-420,635</b>	<b>-549,749</b>	<b>-849,621</b>	<b>274,644</b>	